

*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisionit Rregulator  
Dt.22.01.2021, ora 17:30*

22.01.2021

Ora 17:35

## RENDI I DITËS

Shqyrtimi i projektvendimit "Rregullat proceduriale për përdorimin e kamerave regjistruese e monitorëve (ekraneve) në vendet e numërimit të votave dhe transmetimin në kohë reale nga vendet e numërimit të votave në ambientet e KQZ-së për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021".

### PJESËMARRJA:

#### Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

- Komisioni Rregulator:

1. Znj.Ilirjana NANO	Kryetar
2. Z.Arens ÇELA	Anëtar
3. Z.Dritan ÇAKA	Anëtar
4. Znj.Helga VUKAJ	Anëtar
5. Z.Muharrem ÇAKAJ	Anëtar

- Stafi i KQZ:

1.Z.Ylli MERKAJ	Sekretar i Përgjithshëm
2.Z.Nexhmi MEZANI	Drejtoria IT
3.Z.Petrit GJOKUTA	Këshilltar i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

- Parti Politike :

1.Z.Ivi Kaso, Z.Ledio Nuraj	Përfaqësues të PD-së
2.Z.Altin Kaziaj	Përfaqësues i LSI-së

**Zonja Ilirjana Nano:** Mirëmbrëma të nderuar kolegë!

**Paneli:** Mirëmbrëma!

1

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisionit Rregulator*

*Dt.22.01.2021, ora 17:30*

**Zonja Ilirjana Nano:** Fillojmë atëherë seancën e sotme e cila ka vetëm një pikë në rendin e ditës; Shqyrtimin e projekt-vendimit për rregullat, procedurat, dhe veprimet proceduralë për përdorimin e kamerave regjistruese, monitorëve, ekraneve, në vendet e numërimit të votave dhe transmetimi në kohe reale nga vendet e numërimit të votave në ambientet e KQZ-së, për zgjedhjet e Kuvendit të datës 25 prill 2021. Në mbledhje janë të pranishëm të 5 anëtarët e Komisionit Rregulator, janë të pranishëm përfaqësues të partive politike dhe nga administrata e Komisionit Qendorr të Zgjedhjeve është Sekretari i Përgjithshëm, zoti Merkaj, si dhe zyrtarë të tjerë të administratës së KQZ-së. Duke qenë së mbledhja e Komisionit Rregulator është vënë në lëvizje pas njoftimit të Komisionarit Shtetëror të Zgjedhjeve, do të ftoja përfaqësuesin e KQZ-së, zotin Merkaj, të prezantonte projektaktin dhe relacionin bashkëlidhur në mënyrë të përbledhur. Zoti Merkaj, fjala për ju!

**Zoti Ylli Merkaj:** Mirëmbrëma! Referuar nenit 22 të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja ka kompetencë të instalojë dhe përdorë sistemet e video-monitorimit në qendrat e votimit, si dhe kur bëhet numërimi manual i votave në vendin e numërimit të votave, për të monitoruar dhe provuar rregullshmërinë e procesit dhe të mjidiseve të brendshme të tyre. Gjithashtu neni 22 paragrafi c i Kodit Zgjedhor parashikon përdorimin e sistemeve ose pajisjeve të teknologjisë së informacionit, i cili bëhet në përputhje me rregullat e posaçme lidhur me procedurat dhe aspektet e veçanta të procesit. Këto rregulla procedurale, për këtë qellim, bëhen me akt normativ të KRR-së. Gjithashtu referuar neni 24, pika 4, të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja vendos përdorimin e kamerave me rezolucion të lartë, dhe të monitorëve dhe të ekraneve për shfaqjen e fletës së votimit përpara vlerësimit të tyre. Në bazë të nenit 94 pika 4 e kodit zgjedhor, Komisioni Rregulator me vendim nr. 8, datë 14 dhjetor 2020,




*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisionit Rregulator*

*Dt.22.01.2021, ora 17:30*

ka miratuar përdorimin e kamerave regjistruese në vendin e numërimit të votave dhe në pikën 3 të dispozitivit, ka vendosur përdorimin e kamerave regjistruese dhe monitorëve dhe sistemet e transmetimit video në kohe reale, nga vendet e numërimit të votave në ambientet e KQZ-së. Kjo do të bëhet në bazë të rregullave procedurale të ngarkuara me akt normativ nga Komisioni Rregulator. Referuar kësaj pike të dispozitivit të KRR-së, kemi përgatitur aktin e mëposhtëm në të cilin kemi përgatitur edhe rregullat procedurale të cilat duhet të përdoren në vendnumërimin e votave. Në paragrafin e parë të projektvendimit kemi vendosur karakteristikat teknike të pajisjeve, kamerat e monitorimit, rezolucioni dhe shpejtësia e regjistrimit, dhe cilësia e monitorit. në krahasim me ato që kanë qenë, kemi një rritje cilësore, dhe, dukshëm, nga një mega-pixel kemi vendosur tre mega-pixel, si dhe shpejtësia e regjistrimit nga 16 është vendosur për 25 Ram. Për cilësinë e regjistrimit është të njëjta me ato që do të shfaqen me imazhe edhe në monitor. Regjistrimi do të jetë i dyfishtë, për garancinë, ruajtjen dhe përdorimin e mëvonshëm të këtyre imazheve. Çdo imazh i transmetuar dhe i regjistruar do të jetë i shoqëruar me numrin e tavolinës në të cilën do të bëhet numërimi i votave. Gjithashtu edhe evidentimi i momentit të fillimit dhe përfundimit të procesit të numërimit të fletëve të votimit për çdo qendër votimi. Kjo gjë do të ndihmojë ata që do të duhet të përdorin filmimet për të përcaktuar parregullsitë e pretenduara më vonë. Si kamerat e vrojtimit, edhe kamerat në tavolinë, gjatë procesit të numërimit do të transmetojnë, imazhet pranë zyrave qendrore të KQZ-së, në çdo kohë kur paraqitet ndonjë problematikë ose kur kërkohet nga komisioni qendror i zgjedhjeve. Transmetimi i imazhit të kamerave nuk është bërë në zgjedhjet e mëparshme dhe është risi në këto zgjedhje. Në paragrafin e dytë të projekt vendimit, bëhet fjalë për ruajtjen e dorëzimit të materialit filmik në KQZ. Në paragrafin e katërt është parashikuar edhe afati i ruajtjes së materialit në pajisjet e



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisionit Rregulator*

*Dt.22.01.2021, ora 17:30*

regjistrimit i cili do të jetë deri në fund të verifikimit pas zgjedhor të pajisjeve apo sistemeve të teknologjisë informatike deri në hapjen e kutive. Bashkëlidhur keni projekt-vendimin për shqyrtim dhe miratim. Faleminderit!

Gjithashtu ky projektvendim ka parashikuar edhe lidhjen nr. 2, në të cilën është vendosur edhe kostoja e shërbimit administrativ të këqyrjes dhe vlera financiare e video-regjistrimit. Për këtë kemi bërë një studim tregu, ku kemi parashikuar së sa është vlera e një pajisje. Kemi marrë tre oferta; një pajisje e cila është me kapacitet standard 2 terrabajtë, e cila është menduar për të dhënë të paktën shkëmbimin e të dhënavë me 50 megabit për sekondë. Nga çmimi mesatar që na kanë dhënë tre vlerat që kemi marrë, ka dalë 12500 lekë. Gjithashtu kemi bërë edhe koston e shërbimit administrativ, të cilën e kemi parashikuar referuar kostos së orës së punës për një specialist të administratës. Mendoj që ky ishte relatiqi! (prezantimi!) Faleminderit!

**Zonja Ilirjana Nano:** Zoti Merkaj, faleminderit!

Në fakt sikundër ju e thatë, në datën 14 dhjetor 2020, me vendim nr. 8, KRR ka miratuar vendimin për përdorimin e kamerave regjistruese dhe monitorëve për shfaqjen e fletëve të votimit në vendet e numërimit të votave, për zgjedhjet për kuvendin, të datës 25 prill 2021; dhe konkretisht në pikën 3 të këtij vendimi është përcaktuar që rregullat procedurale për përdorimin e kamerave regjistruese dhe monitorëve si dhe sistemi i transmetimit video në kohe reale nga vendet e numërimit të votave do të bëhet me akt normativ të KRR-së. Sigurisht e vlerësojmë si një akt të rëndësishëm, që vjen sot për shqyrtim dhe miratim, duke pasur parasysh edhe përbajtjen e tij; pasi kemi një përmirësim të parametrave teknikë të kamerave apo pajisjeve; kamerave regjistruese dhe monitorëve, krahasuar me zgjedhjet e kaluara.




*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisionit Rregullator  
Dt.22.01.2021, ora 17:30*

Në këtë moment unë do të çelja diskutimin në parim, lidhur me projekt vendimin; së pari u drejtohem kolegëve, anëtarë të KRR-së të diskutojnë në parim mbi projektvendimin! Zonja Vukaj!

**Zonja Helga Vukaj:** Përshëndetje kolegë! Përshëndetje edhe për pjesëmarrësit e tjerë! Në lidhje me aktin, e konsideroj po aq të rëndësishëm sa edhe u shpreh zonja Nano, për vetë faktin që jo vetëm përbën risi, në kushtet e një teknologjie të rritur, por nga ana tjetër në cilësinë e dokumentacionit merr një vlerë të shtuar në rast së palët do të kenë ankimime apo atakime të rezultateve, dhe si i tillë, vërtetë meriton, dhe besoj së administrata e ka dhënë vëmendjen e duhur dhe në këtë kontekst, do të thoja dhe do të doja, mendoj së edhe kolegët e tjerë do ta kenë konstatuar, që administrata në lidhjen 1 dhe 2 duhet të bashkëlidhë edhe komponentët e tjerë, pra, siç zoti Merkaj na i përmendi, është bërë një studim tregu, pa kanë dalë edhe ato çmimi!, ... sepse përveç së atributeve normuese, ne nuk mund të marrim si KRR asnjë atribut tjetër, si të teknikalitetave IT apo më gjerë, kështu që, në këtë kuadër do të doja që bashkëlidhur këtij akti, të vinin këto dy lidhje të nënshkruara, dhe të bazuara me dokumentacion shtesë ose plotësues, të cilët do të ishin një komponent i rëndësishëm për të arritur në shifra apo parametra të qëndrueshme. Këtë kisha unë. Nuk e di nëse edhe ju e keni pasur këtë konstatim! Mendoj që është e rëndësishme për aktin në tërsi. Faleminderit!

**Zonja Ilirjana Nano:** Faleminderit zonja Vukaj! Kolegët e tjerë! Po zoti Çakaj!  
Po!

**Zoti Muharrem Çakaj:** Dakord jam edhe unë me gjetjen e zonjës Vukaj! Sigurisht që e dëgjova me vëmendje relativin e bërë nga Sekretari i Përgjithshëm i



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisionit Rregulator*

*Dt.22.01.2021, ora 17:30*

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, zoti Merkaj; në kuadër edhe të transparencës mirë do të ishte që bashkëlidhur aktit të kishim edhe metodologjinë ku është bazuar administrata e KQZ-së, për të nxjerrë së pari, koston dhe së dyti, parametrat teknikë që janë përkatësish në lidhjet 2 dhe 1 bashkëlidhur këtij akti që ne po miratojmë.

**Zonja Ilirjana Nano:** Faleminderit zoti Çakaj! Kolegët e tjerë! Atëherë, në së kolegët e tjerë nuk kanë diçka për të thënë në parim, po kaloj tek përfaqësuesit e partive politike. Zoti Kaso, zoti Kaziaj, zoti Nuro, ... ?! Nëse keni diçka për të thënë lidhur me diskutimin në parim të projektaktit!

**Zoti Ivi Kaso:** Faleminderit zonja Kryetare! Parimisht jemi dakord me aktin! Është praktikë tashme e konsoliduar e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që nga viti 2009, në mos gaboj, që, kryen këtë proces të filmimit të procesit të numërimit të votave dhe transmetimit të tyre për vëzhguesit, dhe ruajtjes dhe verifikimit të mëvonshëm të imazheve filmike, në kuadër të procesit ankimor ose të proceseve të mëtejshme që kërkojnë kandidatët. Normimi i këtij procesi sigurisht është i rëndësishëm; aq më tepër që vjen me disa risi, të cilat synojnë përmirësimin e procesit; parimisht shprehëm dakord me aktin dhe e vlerësojmë! Kur të kalojmë tek diskutimet nen për nen kemi dy sugjerime të vogla të cilat synojnë përmirësimin e aktit.

**Zonja Ilirjana Nano:** Po patjetër! Faleminderit zoti Kaso! Zoti Kaziaj?!

**Zoti Altin Kaziaj:** Po faleminderit zonja Kryetare! Përshëndetje të gjithëve! Ne nga ana jonë jemi dakord me qëllimin në vetvete të aktit, si dhe ushtrimin e kompetencave të rregulatorit lidhur me normimin e këtij akti; po ashtu jam dakord



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisionit Rregulator*

*Dt.22.01.2021, ora 17:30*

edhe me pjesën shpjeguese të zotit Merkaj, për sa i përket risisë që sjell ky akt. Është shumë i rëndësishëm procesi i transparencës si dhe procesi i provueshmërisë siç tha zonja Vukaj në fjalën e saj; bëj me dije komisionin rregulator që nuk na është dërguar bashkë me aktin lidhja 2 e këtij akti; në kemi marrë vetëm një lidhje! Kështu që nuk jemi njohur me të! Ashtu siç tha edhe kolegu Kaso kur të vijmë tek miratimi nen për nen do të kemi edhe në pretendimet tona.

**Zonja Ilirjana Nano:** Faleminderit zoti Kaziaj! Së pari bashkohem me atë që kolegët Vukaj dhe Çakaj parashtruan në parim për projektin që gjatë zbardhjes dhe para firmosjes së projekt aktit që do të miratojmë sot, nga ana e administratës, të nënshkruhet edhe lidhjet 1 dhe 2 për shkaqe që sikundër thamë, lidhen me aspekte teknike të parashikuara në projektvendim. Atëherë nëse nuk kemi diskutime të tjera, do të ftoja kolegët të votonin në parim projektvendimin.

**Kush është dakord në parim me projektaktin?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Cela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** s'ka!

Atëherë me pesë vota pro miratohet në parim projektvendimi për rregullat procedurale për përdorimin e kamerave, pajisjeve regjistruese, monitorëve, ekianeve në vendet e numërimit të votave dhe transmetimit në kohë reale nga vendet e numërimit të votave për në ambientet e KQZ-së, për zgjedhjet e Kuvendit të datës 25 Prill 2021.

Atëherë të nderuar kolegë do të fillojmë diskutimin për çdo pikë të projekt vendimit.

**Pika e parë!**

Komisioni Rregulator vendosi të miratojë rregullat procedurale për përdorimin e kamerave, pajisjeve regjistruese, monitorëve, ekianeve në vendet e numërimit të



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisionit Rregulator*

*Dt.22.01.2021, ora 17:30*

votave dhe transmetimit në kohë reale nga vendet e numërimit të votave për në ambientet e KQZ-së, për zgjedhjet e Kuvendit të datës 25 Prill 2021, sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi. Atëherë më duhet të lexoj lidhjen 1, edhe pse zoti Merkaj e paraqiti në mënyrë të përbledhur. Kjo për shkak së jemi në momentin e diskutimit pikë për pikë apo nen për nen të projektvendimit. Më duhet të lexoj, pra, lidhjen 1, ku edhe referohet pika 1 e këtij vendimi.

Lidhja 1

1. Në çdo tavolinë numërimi, në vendet e numërimit të votave të instalohet një kamera, në mënyrë të tillë që të realizojë regjistrimin video për vlerësimin e çdo flete votimi.
2. Parametrat teknikë minimalë për kamerën të jenë: rezolucioni jo më i vogël së tre megapixel; shpejtësia e regjistrimit video jo më e vogël se 25 *frames* për sekondë;
3. Kamerat të transmetojnë në kohë reale procesin e numërimit të votave në një monitor ekran të vendosur përballë vëzhguesve të subjekteve zgjedhore.
4. Madhësia e ekranit jo më e vogël së 32 inç, imazhi i transmetuar në ekran duhet të zërë të gjithë hapësirën e ekranit pa konture apo hapësirë boshe. Imazhi i fletës së votimit në ekran të zërë jo me pak së 80% të ekranit.
5. Të gjitha imazhet e marra nga kamerat duhet të regjistrohen në forme digitale, gjatë gjithë procesit të numërimit të votave.
6. Regjistrimi duhet të kryhet me rezolucionin e transmetimit të imazhit në ekran dhe duhet të krijojë mundësi për kontrollin e pamjen e mëvonshme të të gjithë regjistrimeve të kryera.
7. Pajisjet e regjistrimit duhet të kryejnë regjistrim të dyfishtë, të njëkohshëm, në dy njësi të brendshme të pavarura.
8. Në çdo imazh të transmetuar dhe të regjistruar të jenë të evidentuar numri i tavolinës në të cilën po numërohen votat; të evidentohet qartë në transmetim dhe




*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisionit Rregulator*

*Dt.22.01.2021, ora 17:30*

regjistrim momenti i fillimit dhe përfundimit të procesit të numërimit të fletëve të votimit për çdo qendër votimi.

9. Në çdo VNV të instalohet një kamera vrojtimi 360° që të mbulojë të gjithë hapësirën e sallës në vendin e numërimit të votave. Kamera gjatë gjithë kohës duhet të registrojë të gjithë hapësirën pavarësisht nga orientimi i kërkuar në momente të caktuara dhe të mundësojë regjistrimin video dhe audio të sallës.
10. Kamera e vrojtimit dhe kamerat e tavolinave të numërimit duhet të transmetojnë imazhe pranë zyrave qendrore të KQZ-së, në çdo kohë kur paraqitet ndonjë problematikë ose kur kërkohet nga KQZ.
11. Transmetimi i imazheve bëhet në rrjet të myllur, të pavarur dhe me kapacitet të nevojshëm qarkullimi online.
12. Në ambientet e KQZ-së duhet të krijohen mundësi monitorimi të njëkohshëm për të paktën 8 VNV dhe 8 tavolina numërimi.
13. Procesi i numërimit dhe transmetimit në të gjitha VNV-të duhet të ketë pavarësi nga energjia elektrike për të paktën minimumi dy orë.  
Atëherë lexova pikën 1 të projekt vendimit dhe lidhjen 1 ku ajo referon.  
Po çelim diskutimin për pikën 1 sipas rregullores;  
Së pari të drejtën e fjalës e kanë përfaqësuesit e partive politike për të paraqitur, nëse kanë, komente apo sugjerime, propozime për shtesa apo ndryshime.  
Po zoti Kaso, ju lutem!



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*  
*Komisioni Rregullator*  
*Dt.22.01.2021, ora 17:30*

**Z.I.Kaso:** Faleminderit znj. Kryetare! Kam një koment në lidhje me piken një dësygjerime përmiresime. Veçanërisht për sa I përket aneksit tek e cilia ato referojn. Konkretisht do ta filloja nga formulimi I pikes një, ku ashtu siç e tha *Sekretari I Përgjithëshëm* I cili relatoj aktin që për herë të parë futet nociioni I trasmetimit në kohë reale nga vendet e numërimit të votave jo vetem në ekranet që janë për vëzhguesit, por edhe *Komisionit Qendor te Zgjedhjeve* dhe rregullat konkretisht për këtë përcaktohen nga **Aneksi 1** përkatesisht në **pikën 10**. Çështja është që porcesi numërimi votash është shumë I shtuar sigurisht edhe sensitiviteti I transmetimit të këtij procesi në *Komisionin Qendor te Zgjedhjeve* për njëmijë e një arsyebart të njëtëndjeshmëri. Dhe sigurisht kjo nuk mund të lihet e pa normuar ose në diskercion të **KQZ** si një nociion I përgjithëshëm po pa specifikuar se kush. Pra, nuk besoj se është e arsyeshëm që në çdo moment fjala vjen Administrata e *Komisionin Qendor te Zgjedhjeve* ta shikoj të arsyeshëme. Numri I imazhet direkte të numërimit të një kutie të rëndësishteme që ndan rezultatin në një zonë zgjedhore të trasmetohen në *Komisionin Qendor te Zgjedhjeve* dhe vetë subjektet politike janë ruajtur dhe në teori e kanë të pamundur që të komunikojn ose të kenë aksese tek grupet e numërimit të votave në momentet e numërimit pasi në momentete që ato janë antarët e grupit të numërimit të votave të emëruar si të tillë nga ne, *Komisionin Qendor te Zgjedhjeve* ata janë Administrata *Komisionin Qendor te Zgjedhjeve*, por atyre u parandalohet le të themi çdo mundësi e ndikimit të jashtëm, qofshin këto ndikime dhe të partive, subjeketeve që I kanë emeruar ata. Prandaj do të sygjeroja që për ta normuar dhe për ta disiplinuar këtë situat, vërtet mund të kemi situata specifike, raste të vecanta



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Rregulator  
Dt.22.01.2021, ora 17:30*

ne cilat mund të jetë e domosdosheme ose e nevojshëme që pamjet direkte të numerimit të fletëve të votimit të një qendre të caktuar të trasmetohen në **Komisionin Qendor të Zgjedhje**, por kjo duhet të bëhet vetëm me vendim të **Komisionerit Shteteror per Zgjedhjet**, pra që ka, është titullar I instituzionit ai që mban përgjegjësin e veprimtarisë së insitucionit të tillë dhe rast pas rasti kur kjo kërcohë janë arsyë përjashtimore shpresojm të mos kërcohë asnjëherë për mos të na sjell situat. Në këndvështrimin tonë duhet patjetër me vendim të **Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet**, pra jo secili punonjës I administrates, fjala vjen me të cilet nuk është se kemi asnjë rezerv po që e marrë si shembull të përgjithshëm ose kujtdo që I shkrepet nga teknika, nga IT **Komisionin Qendor të Zgjedhjeve** merrë përsiper që të transferoj dhe të trasmentoj live imazhin e numërimit të një qendre votimi të caktuar. Prandaj do të sygjeroja që në *piken 10 te Aneksit 1* të shtohej në përfundim të fomulimit pra ku thuhet : “... pranë zyrave qendore të KQZ në çdo kohë kur paraqitet ndonjë problematik ose kur kërcohë nga KQZ, me vendim të Komisionetit Shtetëror për Zgjedhjeve.”. Ky është sygjerimi parë. Ndërkohë kam dhe një sygjerim tjetër përsa I përket pikës 8-të të po të njëjtit imazh, me fal të së njëtës **Aneks** ku flitet për pjesën e imazheve të trasmetuara dhe të regjistrara kërcohë që të evidentohet numëri I tavolinës në të cilën po numërohen votat, që është I domosdoshëm, si dhe të evidentohet qartë në trasmetimin dhe regjistrim momenti fillimit dhe përfundimit të procesit të numërimit fletëve të votimit për çdo qendër votimi. Do të sygjeroja të shtohet që përpara numërimit të çdo kutie votimi të kaloj poshtë kamrave, të paraqitet poshtë kamerave një flet e bardh me numërin e fletës së votimit, më fal, numërin e qenderës së votimit që do të numërohet në menyrë që kjo të mbetet e regjistruar dhe verifikimet e mëpasshme ta bëjn të mundur lehtësisht ndarjen e qendrës së votimit e cila është numëruar dhe imazhet filmike janë ruajtur. Faleminderit!



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.22.01.2021, ora 17:30*

**Znj.I.Nano:** Po z. Kaso faleminderit! Ju keni sygjerime për dy ndryshime, një te pika 10-të e lidhjes një dhe një te pika 8-të e lidhjes 1. Në të parën, thjesht po e përbledh në të parën propozoni që trasmetimi në rastin e problematikave ose kur e kërkon **KQZ** të bëhet me akt të Komisionetit, me vendim that ju të *Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.*

**Z.I.Kaso:** Po.

**Znj.I.Nano:** Në pikën 8-të para se të filloj numërimi këkroni të shton edhe evidemntimin, pra regjistrimin e numërit të qenderes së votimit.

**Z.I.Kaso:** Po. Poshtë kamerës që do të regjistroj të paraqitet një flet e bardhë format A4 e cila të përmabaj numrin e qendrës të votimit e cila do të numërohet. Është një proces krejt I lehtë nga ana teknike, por I domosdoshëm për ato verifikimet e mëvonshme në të cilat per hirë të së vërtetës në praktik kanë pas vëshirësi të shumta pasi si neve dhe palët e tjera në proces kanë kaluar nëpërmjet këtij procesi verifikimi të mëvonshëm të pajmve filmike dhe evidentimi I qendrës së votimit, imazhte e të cilës po shihen.

**Znj.I.Nano:** Po shihen. Okej e qartë.

**Z.I.Kaso:** ... vetëm nga vulat që mbajn fletët e votimit nga mbrapa është pothuajse I pamundur. Ndoshta resoluzioni I rritur mund ta përmirësoj këtë pjesë, por ne sygjerojm edhe këtë zgjidhjen alternative.



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisioni Rregulator*

*Dt.22.01.2021, ora 17:30*

**Znj.I.Nano:** Dakord z. Kaziaj ju keni për pikën një të *projekt vendimit* ndonjë koment apo propozim për shtesa/ndryshime?

**Z.A. Kaziaj:** Thjesht bie dakord me z. Kaso përsa I përket pjesë së teknikaliteteve që sjellin transaparençë në proçes. Nuk kisha ndonjëgjë konkrete, të themi.

**Znj.I.Nano:** Dakord. Faleminderit! Atëherë të ndreuar koleg fjala është për ju për pikën një e cila referon te lidhja një e *projekt vendimit*. Znj. Vukaj!

**Znj.H.Vukaj:** Në vijim të ndrëhyrjes që bëra në krye të herës, pra në lidhje me dy shtosat apo lidhjes të cilat duhen nënshkrua nga *Administrata* sugjeroj dhe propozoj në të njëtën kohë që pas fjalëve “*sipas lidhjes një*” te shtohet “*përgatitur nga administrata*” dhe më pas “*bashkolidhur këtij vendimi*”. Ky propozim vlen edhe për pikën tre “*sipas lidhjes dy përgatitur nga administratë, (presje) bashkolidhur këtij vendimi*”. Faleminderit!

**Znj.I.Nano:** Kolegët? Z. Çaka.

**Z.D.Çaka:** Atëherë. Po. Unë do doja thjeshtë një sygjerim për formulim më shume të pika 4 e lidhjës një.

**Znj.I.Nano:** Te lidhjes një?

**Z.D.Çaka:** Ku themi: “*Madhësia e ekarnimit jo më e vogel se 32 inç.*” mendoj të shtohet togfjalëshi: “*duhet të jetë*”, pra “*madhësia e ekrenit duhet të jetë jo më e vogel se 32 inç*”. Kjo eshte thjeshte me shume gjuhesisht.



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*  
*Komisioni Rregulator*  
*Dt.22.01.2021, ora 17:30*

**Znj.I.Nano:** Gjuhësish? Po?

**Z.D.Çaka:** Po.

**Znj.I.Nano:** Dakord koleg? Z. M.Çakaj? Z.Çela?

**Z.M.Çakaj:** Unë jam personalisht dakort dhe me propozimte e përfaqësuesësve të partive politike. Sigurisht jam dakort dhe me propozimin e znj. *Vukaj*. Kështuqë nuk kam asgjë për të shtuar. Edhe me propozimin e Z. N. *Cakaj* jam dakort.

**Znj.I.Nano:** Dakord. Besoj z. *Caka* vetëm kërkoj një korrektim nga ana gjuhësore. Nuk besoj se është propozim për shtesa apo ndryshim.

**Z.M.Çakaj:** Po dakort jam dhe me atë. Dhe me korrektimin.

**Znj.I.Nano:** Meqënëse jemi duke folur për propozimet lidhur me atë që z. *Vukaj* propozoj unë mendoj që personalisht nuk e gjej me vend të shtohet në **Ankt**. Për mua nuk e ndihëmon teknikën legjislative në menyrën e hartimit të Akteve, sepse ne fakt I gjithë Akti dhe lidhjet janë pjesë përbërëse të aktit. Janë përgatitur nga Administrata dhe vinë me firmën e **Komisionerit** në **Komisionin Rregulator**. Pra, lidhjet janë pjesë përbërëse e aktit. Dihet që ky është një ndër aktet që është propozuar nga Administrata. Mendimi im personal. Atëherë të nderuar koleg kemi tre propozime. Dy propozime të z. *Kaso* dhe një propozim të znj. *Vukaj* për tu shtuar në ketë pikë. Pastaj kur të vi rradha përsëri te pika tjetër për të shtuar “*përgatitur*” dhe “*nënskruar nga administrata*” apo jo znj. *Vukaj*?



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*  
*Komisioni Rregulator*  
*Dt.22.01.2021, ora 17:30*

**Znj.H.Vukaj:** “Përgatitur nga administrata”, sepse nënshkrimi është defakto I dukshëm kur të na vi I tillë.

**Znj.I.Nano:** “Përgatitur nga administrata”. Atëherë më së pari do të doja të votoja ...

**Znj.H.Vukaj:** Kjo është garanci që I jep Aktit njëkohësisht I bënë të kuptoj palët që ka përgjëshmëri në nxjerjen e atyre të dhënavë, por dhe organet e tjera audituese apo që do kontrollojn kostot e dhena apo detaje të tjera.

**Znj.I.Nano:** E qartë. Atëherë më së pari më duhet të votoj propozimin e *znej. Vukaj* pasi bëhet fjalë te teksti I projekt aktit. Më pas propozimet e z. *Kaso*. Atëherë propozimi I *znej. Vukaj* është që të shtohet pas togfjalëshit “*sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi*” të shtohet togfjaleshi “*përgatitur nga Administrata e Komisionit Qendor te Zgjedhjeve*”.

**Të nderuar kolegë kush është dakort me propozimin e *znej. Vukaj*?**

**Pro:** 2 (*znej. Vukaj, z. Çakaj*)

**Kundër:** 3 (*znej.Nano, z. Çela, z. Çaka*)

Nuk miratohet propozimi i *znej. Vukaj*. Kalojmë te propozimi i parë i z. *Kaso*. Propozimin e parë z. *Kaso* më lejoni që ta marrë sipas pikave që votohen pra edhe pse propozimi i parë ishte për pikën 10 të filloj nga propozimi dy që lidhet me pikën 8?

**Z.I.Kaso:** Nuk ka problem.

**Znj.I.Nano:** Faleminderit! Atëherë kemi një propozim në lidhjen 1 bashkëlidhur këtij vendimi. Ne pikën 8-të “*në çdo imazh të transemetuar dhe të regjistruar të*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregullator  
Dt.22.01.2021, ora 17:30*

*jenë numri I tavolinës në të cilën po numërohen votat. Të evidentohet qartë në trasmentim dhe regjistrim momenti I fillimit dhe përfundimit të procesit të numerimit të fletëve të votimit për çdo qendër votimi. Para fillimit të procesit të numërimit të fletëve të votimit kamera ... “apo “gjatë procesit”, z. Kaso? Z. Kaso ju lutem. Po.*

**Z.I.Kaso:** Përpara se të filloj të numërohet një kuti votimi të evidentohet ...

**Znj.I.Nano:** Numëri I qendrës së votimit.

**Z.I.Kaso:** ... flas nga kamerat numëri I qendrës së votimit .

**Znj.H.Vukaj:** Pra idea z. Kaso është që kjo fletë e bardh, e bardh me numrin të jetë aty statike, prezent gjatë të gjithë kohës?

**Z.I.Kaso:** Ose të evidentohet në moemntin e parë. Ka disa mënyra. Një mënyrë është që të evidentohet një here.

**Znj.I.Nano:** Thelbi është evidentimi I numrit të qendrës së votimit fletët e së cilës do të numërohen në vijim. Prandaj thash momenti para fillimit të numerimit. Meqënëse kemi edhe dy ...

**Z.P.Gjokuta:** Mundet?

**Znj.I.Nano:** Po z. Gjokuta, ju lutem!




*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*  
*Komisioni Rregulator*  
*Dt.22.01.2021, ora 17:30*

**Z.P.Gjokuta:** Faleminfderi! E drejt është ajo që thotë z. *Kaso* por unë mendoj se në shprehjen që është tek lidhja pikërisht kjo ka qënë qëllimi. Ndofta do fiksuar, po evidentimi I momentit të fillimit dhe të përfundimit të numërimit të çdo qendër votimi. Qendra e votimit evidentohet me numër. Kështuqë ato pastaj janë tekanlitete se si do të vihet numri. Do vihet në flët të bardh, do vihet në flet tejtër, po ky është thelbi I shprehjes në atë pikë.

**Znj.I.Nano:** Pra momenti I fillimit dhe momenti I mbarimit për çdo qendër votimi të numërimit. Po z. *Cakaj*.

**Z.M.Çakaj:** Atëherë pavarësisht se *Administrata* besoj mund të na në hartimin e aktit mund të jetë përfshirëdhe z. *Gjokutaj*, po dhe pavasisht se administrata e *KQZ* mund të ketë pasur atë në mend dhe pavarësisht dhe *Rregulatori* kur ka miratuar shumë *projekt akte* ka pas shumë gjëra në mend nevoja ka lindur që aktet të sqarohen në mënyrë të detajuar. Kështu që unë e gjej me vend sqarimin dhe propozimin e z. *Kaso*, sepse po nuk e shkruajte në mënyr shumë të detajuar mundësishte edhe tre herë pavarësisht se nuk I takon fare teknikës legjislative faktet po tregojn që këtu nuk zbatohen qoftë kodet, qoftë ligjet, qoftë projekt aktet e *Komisinoit Rregulator*. Pavarësishte se bejn pjesë në ato akte që kanë karakter normativ kështu që unë peronalishte e gjej me vend të shtohet kjo. Dhe është një proces shumë I rëndësishëm nisur dhe nga problematikat e evindetuara ndoshta dhe për shkak të rezlucionit të kamerave që nga viti 2009-të e në vijim. Pra nuk bëhet dot lidhja e fletës konkrete të votimit që po numërohet me me numrin përkatës të qendrës së votimit që po numërohet. Nga ana tjetër duhet të kemi parasysh që në një proces, në një VNV, në një proces numërimi votash kutia rri larg, pra nuk edhe



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.22.01.2021, ora 17:30*

mund ta shohi edhe mund mos ta shohi kamera, kështu që nëse ne e normoj këtë proces vetëm mirë I bëjm procesit në kuadër të transparencës.

**Znj.I.Nano:** Atëherë Z. Muhamrem Cakaj. Po z. Gjokuta, ju lutem!

**Z.P.Gjokuta:** Më fal, se ndoshta u keq kuptuam nuk thash mos të shihet po thash që edhe ajo shprehja këtë qëllim ka. Akti ndofta do shkruar duke evidentuar dhe numrin. Specifikohet ajo që tha z. *Kaso*.

**Znj.I.Nano:** Duke evidentuar dhe numrin Z. *Kaso* parmisht edhe unë më lejoni ta shpreh që jam fare shumë dakord me propozimin tuaj pasi janë problematika të evidentuara në zgjedhjet e mëherëshme. Është e mjaftueshme për ju “duke evidentuar numrin e qendrës së votimit” që ta shtrojm për propozim?


**Z.I.Kaso:** Dakord!

**Znj.I.Nano:** Ta hedhim në votim. Më falni.

**Z.I.Kaso:** Po dakord. “Duke evidentuar numerin e qendrës së votimit.”

**Znj.H.Vukaj:** “Përpara se të filloj procesi I evidemtimit në kamera”.

**Znj. I. Nano:** Në fakt ajo është gjatë të gjithë procesit. Në fakt teknikisht ajo është gjatë të gjithë procesit sepse dihet që numërohen fletët e votimit të një qendre pastaj kalojm në në qendër tjetër. Z. Çakaj, ju keni ndonjë mendim?



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*  
*Komisioni Rregulator*  
*Dt.22.01.2021, ora 17:30*

**Z.M.Çakaj:** Per mua siç e thashë mos të kalojmë në përsëritje është shumë e rendësishme të sqarohet në mënyr të qartë dhe shteruse ky moment proçedurial. Pra, kamera përparrë paraqitjes të çdo kutie të një qendre votimi të evidentohet në mënyr të qartë. Së pari numrin e qendrës së votimit dhe mëpas, pra përparrë hapjes numrin e qendrës së votimit dhe në përfundim, pra me rradhë numrin e qendrës pasardhëse të votimit. Pra, per çdo qendër votimi që numërohet duhet të evidentohete në mënyr të qartë. Kshuqë edhe propozimi I parë I z. *Kaso* edhe ky propozimi përsakohë ka këtë qellim dakort jam.

**Znj.I.Nano:** Atëherë më lejoni. Më lejoni ta lexoj siç e kam kupruar unë propozimin. Në fjalin e dytë të pikës së 8-të “të evidentohet qart në trasmetim dhe regjitim momenti I fillimi dhe përfundimit të procesit të numërimit e fletës të votës të çdo qender votimit si dhe të evidentohet qartësisht numri I qendrës së votimit.”. Z. *Kaso* ta votojm këtë propozim tuaj? Pra, fillimi, mbarimi dhe numri I qendrës?

**Z.I.Kaso:** “Evidentimi I qendrës”, dakord.

**Znj.I.Nano:** “Evidentimi I numrit të qendrës së votimit”.

**Z.I.Kaso:** Dakort!

**Znj.I.Nano:** Atëherë të nderuar kolegë votojmë propozimin e paraqitur për një shtesë në pikën tetë të lidhjes 1 të projektvednimit.

**Kush është dakord me evidentimin e numrit të qendrës së votimit?**

**Pro:** 5 (z. *Nano*, z. *Çela*, z. *Çaka*, z. *Vukaj*, z. *Çakaj*)

**Kundër:** s'ka

Me pesë vota pro miratohet propozimi i z. *Kaso*. I lutem Adminstratës gjatë zbardhjes të paraqitet në menyrë korakte propozimin që porsa u miratua. Kalojmë në propozimin tjetër që ka ardhur për pikën një konkretisht për lidhjen një. Bëhet



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Rregulator  
Dt.22.01.2021, ora 17:30*

fjalë për pikën 10-të të lidhjes një ku kërkohet të shtohet “*me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve*”. Kolegë keni ndonjë diskutim lidhur me këtë propozim? Po z. *Çaka*.

**Z.D.Çaka:** Unë personalisht jam dakord me propozimin e bërë nga z. *Kaso*. Kështu që jam dakord me propozimin.

**Znj.I.Nano:** Vendim.. ta lemë me akt të Komisionerit më mirë? Ose nuk e di z. *Kaso* sepse *Komisioneri I* di vetë cfarë vendimesh në kuptimin e ...

**Z.D.Çaka:** Me akt.

**Z.I.Kaso:** Me akt.. Dakord nuk ka problem. Me rëndësi ka që të evidentohet autoriteti që I jep komand për një veprim të tillë edhe teë mbetet me shkrim akti.

**Znj.I.Nano:** Unë përpara se ta shtroj për votim apo dhe të votoja vetë doja të pyesja përfaqësues të *Administrates Komisionit Qendror te Zgjdhejeve* një problematikë e tillë si është zgjidhur në zgjedhjet e klauara?

**Z.I.Kaso:** Nuk ka patur besoj ndërhyrje. Është hera e parë që porpozohet.

**Znj.I.Nano:** Trasmetimi me kohë reale.

**Z.I.Kaso:** Në kohë reale në *Komisionin Qendror*.

**Z.Y.Merkaj:** Në *Komisionin Qendror* nuk ka patur.



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregullator  
Dt.22.01.2021, ora 17:30*

**Znj.I.Nano:** Në zyrat qendrore. Dakord. Mirë atëherë votojmë propozimin e z.  
*Kaso* ku në pikën 10-të të lidhjes një kërkohet të shtohet togfljalëshi “*me akt të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve*”. Pra, kur kërkohet nga **KQZ**. Idea është që të jetë me një akt të *Komisionerit Shtetror të Zgjedhjeve*.

**Kush është pro këtij propozimi?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** s'ka

Me 5 vota pro miratohet edhe kjo shtesë. Atëherë të nderuar kolegë per shkak se patëm . . . Z. Gjokuta po.

**Z.P.Gjokuta:** Më fal. Dukeqënëse se ka pas një lapsus në shtypjen e materialtit atje te kjo fjalia që “evidentohet numri I grupit, më fal I tavolinës” a mundet si e shikoni të arsyeshme a mundet të shtohet dhe numri I grupit te numërimit? Evidenitimi si I tavolinës dhe I grupit të numërimit.

**Znj.I.Nano:** Në cilën pikë Z. Gjokuta?

**Z.D.Çaka:** Pika 8. Pika 8

**Z.P.Gjokuta:** Pika 8.

**Z.M.Çakaj:** Në pikën 8

**Znj.I.Nano:** Numri I tavolinëa dhe nr I ...

**Z.D.Çaka:** I grupit të numërimit.

**Z.P.Gjokuta:** I grupit të numërimit. Në praktik sidomos gjatë procesit të ankirimmenve, të shqyrtimit të ankimoreve duhet të dali secili grup e ka krye atë proces.

**Znj.I.Nano:** Cili grup. E qartë, e qartë. Atëherë po e formalizojmë propozimim me anën e një antari konkretisht po e bëj unë propozimin të shtohet dhe grupi numërimit. Jo thjesht...



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisioneri Rregulator*

*Dt.22.01.2021, ora 17:30*

**Znj.I.Nano:** Pra në cdo imazh të transmetuar dhe regjistruar te fjalia e parë të pikës 8 të jenë të evidentuar, numri i tavolinës në të cilën po numërohen votat dhe numri i grupit të numërimit, te fjalia e dytë është me shtesën e zotit Kaso.

Kush është dakord me këtë propozim për të shtuar dhe evidentimin e grupit të numërimit, fjalia e parë e pikës 8 të lidhjes 1 që referon pika 1 e projektvendimit?

**Z.M.Çakaj:** A mund të na sqarojë zoti Gjokuta që propozoi bazën ligjore? Tek Kodi zgjedhor nuk po e gjej. Duhet të jetë ndonjë akt normativ i Komisionit Qendoror të Zgjedhjeve që grupet e numërimit numërtohen për korrektesë, nëse ka bazë ligjore brenda mund ta vendosim dhe bazën ligjore.

**Z.P.Gjokuta:** Siç e kuptova pyetjen, ku është baza ligjore për numërtimin e grupeve të numërimit? Ligji ja le kompetencë KQZ-së dhe ju, mesa di unë do të kaloni një akt normativ për të rregulluar ngritjen e grupeve të numërimit, numërtimin e tyre, përcaktimin e sasisë së tavolinave për çdo zonë numërimi në bazë të numrit të qendrave të votimit. Kështu që është një akt i mëvonshëm që ju do ta bëni këtë gjë dhe biles edhe kur vjen te procesi i shortit për përcaktimin e subjekteve zgjedhore, që do të propozojnë anëtarët e grupeve të numërimit, shorti është i mbështetur mbi numrin e grupeve të numërimit. Kështu që është i rregulluar neni në Kodin Zgjedhor.

**Z. M.Çakaj:** Neni 95 po ta kujtoj unë.

**Z.D.Çaka:** 95 pika 5. Megjithatë ka dhe një akt komisioneri që do të vendos grupe numërimi për çdo grup, varet nga sasia e qendrës së votimit. Është në akt të Komisionerit.

*Zbardhi materialin e inçizuar*

*Valbona Dushi*

*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregullator  
Dt.22.01.2021, ora 17:30*

**Znj.I.Nano:** Atëherë zoti Çakaj vota juaj, pro apo kundër këtij propozimi?

**Z.M.Çakaj:** Dakord jam.

**Znj.I.Nano:** Atëherë kush është dakord?

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka

Miratohet dhe kjo shtesë në fjalinë e parë të pikës 8 të lidhjes 1, që referon pika 1 e projektvendimit.

Të nderuar kolegë më lejoni që tashmë pati disa ndryshime të propozuara, disa prej tyre u miratuan dhe një jo, më duhet që ta votojmë në tërësi pikën 1 së bashku me lidhjen 1.

**Kush është dakord me pikën 1 dhe lidhjen 1 me këto ndryshime të miratuara?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka

Miratohet pika 1, kalojmë në pikën 2 të projektvendimit.

Pika 2, regjistrimi filmik video i procesit të numërimit të votave nga kamerat e tavolinave dhe kamerat e vrojtimit në VNV të ruhet në pajisje elektronike të sigurta dhe të dorëzohet në KQZ së bashku me materialet e tjera zgjedhore. Përfaqësuesit e partive politike e kanë fjalën së pari, nëse kanë ndonjë koment apo propozim për shtesë apo ndryshim.

**Z.I.Kaso:** Nuk kemi.

**Znj.I.Nano:** Zoti Kaziaj?

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Valbona Dushi*

X

*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.22.01.2021, ora 17:30*

**Z.A.Kaziaj:** Thjesht ndonjë përcaktim të afatit të ruajtjes, nuk kisha ndonjë shtesë tjetër, ndonjë propozim tjetër.

**Znj.I.Nano:** Afatin e ruajtjes e kemi në pikën 5 të të njëjtit projektvendim.

Lidhur me pikën 2 kemi ndonjë gjë? Nuk kemi, votojmë pikën 2 të projektvendimit sipas draftit të paraqitur nga administrata e Komisionit Qendorr të Zgjedhjeve.

**Kush është pro?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka

Miratohet pika 2 e projektvendimit.

Kalojmë në pikën 3, administrata e KQZ-së të riprodrojë kopje të materialit të regjistruar dhe t'i vërë në dispozicion të subjekteve zgjedhore, nëse i kërkojnë sipas tarifave të përcaktuara sipas, kemi dy **sipas** duhet ta korigojmë gjuhësisht në lidhjen 2 bashkëlidhur këtij vendimi. Atëherë unë do të duhet t'i referohem lidhjes 2, e cila përcakton koston e shërbimit administrativ të kqyrjes dhe vlerën financiare të video regjistrimit.

Në fakt është bazuar në nenin 167 2, pika 6 e Kodit Zgjedhor sipas të cilës Rregulatori miraton Akt Normativ tarifat e shërbimit administrativ të kqyrjes dhe çmimin e video regjistrimit. Në lidhjen 2 siç u paraqit edhe nga Sekretari i Përgjithshëm, kemi regjistrimin në medium me ruajtje së dokumentacionit të jashtëm *ssd solis drive* me format video **mp4** ose çdo format tjetër video lehtësisht i lexueshëm është vendosur një kapacitet teknik dy **terabite**, shkëmbim të dhënat 500 **mgb** për sekondë dhe me vlerë financiare sipas studimit të tregut që ka bërë administrata e KQZ-së 12500 lekë, ndërsa kostoja e shërbimit të kqyrjes do të jetë në varësi të orëve dhe është e përcaktuar për njësi 500 lekë ora.

Po zoti Çaka!

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Valbona Dushi*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.22.01.2021, ora 17:30*

**Z.D.Çaka:** Do të kisha dy propozime, e para tek përmbajtja e pikës 3 të projekt akxit, sepse themi administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të riprodhojë kopje të materialit, ndërkojë në qoftë se do t'i referohemi konkretisht dhe nenit 94 paragrafi 4 i Kodit Zgjedhor, ku njëkohësisht dhe pjesët arsyetuese të projektvendimit është e përcaktuar që KQZ-ja ose kur është e mundur dhe KZAZ-ja të bëjë një riprodhim të tillë, kështu që edhe në koherencë me dispozitat e Kodit Zgjedhoir por njëkohësisht edhe me përmbajtjen e pjesës arsyetuese shtronhet dhe kur është e mundur KZAZ-ja.

**Znj.I.Nano:** Neni 94 pika 4, thatë e Kodit Zgjedhor?

**Z.D.Çaka:** Po.

**Znj.I.Nano:** Po e lexoj për kolegët, fjalia e fundit e nenit 94, pika 4. KQZ-ja ose kur është e mundur edhe KZAZ-ja duhet të riprodhojë kopje të tyre dhe t'i vërë në dispozicion të subjekteve zgjedhore kundrejt një pagese të një tarife që mbulon koston e prodhimit, pra tarifën duke e miratuar tani. Kolegë lidhur me këtë propozim të zotit Çaka, që tenton të transpozojë nenin 94 pika 4 të Kodit Zgjedhor? T'u drejtohem paraprakisht administratës së KQZ-së si hartuese e projektaktit. Po zoti Gjokuta!

**Z.P.Gjokuta:** Është gjë e mirë që të përafrohet me termin e Kodit Zgjedhor, por që nga viti 2009 deri në zgjedhjet e vitit 2019 të paktën është parë që praktikisht e pamundur për arsyen teknike. Mendoni që këto regjistrohen me një pajisje, që është në vendin e numërimit dhe me mbarimin e procesit, pra me nxjerrjen e tabelës përbledhëse të rezultatit, të gjitha pajisjet shkojnë në KQZ dhe ka një proces, ato

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Valbona Dushi*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.22.01.2021, ora 17:30*

janë në një format nga ato pajiset që dhe sikur t'i nxjerrësh në atë moment janë të palexueshme, duhet të konvertohen nga atë variant që thotë lidhja 2.

Do t'i duhej KZAZ-së që të bënte një proces që teknikisht ka vështirësi. Do pajisje shtesë, megjithatë ajo le të vihet se në zgjedhjet e ardhshme ndofta do modernizohemi dhe në vendet e numërimit mund të kenë pajisje të kësaj natyre. Mund të vihet nuk e dëmton, por që ta dini se praktikisht nuk është bërë edhe për këto zgjedhje unë mendoj se sigurisht ajo është një mundësi, të jepet mundësia le të vihet ta dini se nuk është e bëshme teknikisht. Faleminderit!

**Znj.I.Nano:** Faleminderit zoti Gjokuta!

Domethënë edhe ligji këtë ka pasur parasysh që thotë edhe ose kur është e mundur edhe KZAZ.

**Znj.H.Vukaj:** Duke qenë që zoti Gjokuta ishte shumë i qartë në sjelljen retrospektive sesi është proceduar por njëkohësisht dhe përbajtjes që i ka vënë ligjvënësi do të thotë që KZAZ-ja ose ligjvënësi nuk ka qenë i sigurtë nëse a mund ta realizonte KZAZ-ja këtë apo jo.

Në moment që ne themi aplikimin e tarifave për këtë lloj shërbimi edhe sikur KZAZ-ja të kishte të gjithë infrastrukturën, të kishte mundësi të bënte konvertimin etj., KZAZ-ja e ka të pamundur që të bëjë aplikimin dhe menaxhimin e tarifës. Ajo bëhet vetëm nga KQZ-ja.

**Znj.I.Nano:** Ajo në çdo rast nga KQZ-ja sigurisht nuk ka tagër nga KZAZ-ja, nëse është e mundur nga KZAZ-ja ndoshta ka pasur parasysh mundësitë teknike.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Valbona Dushi*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.22.01.2021, ora 17:30*

**Znj.H.Vukaj:** Edhe me këto shtojca që bëmë ne i shtohet edhe kjo lloj vështirësie ose kjo lloj ngarkese le të themi. Kështu që e shoh të pamundur personalisht.

**Znj.I.Nano:** Votojmë propozimin e zotit Çaka për të shtuar ose për të transpozuar fjalinë e fundit të nenit 94, pika 4 duke shtuar togfjalëshin “kur është e mundur edhe KZAZ-ja”. Zoti Çaka a jam e saktë, pra administrata e KQZ-së edhe kur është e mundur dhe KZAZ-ja të riprodhojë. Votojmë propozimin e zotit Çaka.

**Kush është pro?**

**Pro:** 4 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, z.Çakaj)

**Kundër:** 1(znj.Vukaj,)

Miratohet shtesa e propozuar nga zoti Çaka, në pikën 3 të projektvendimit.

Ndërkohë unë thjesht për koherencë te lidhja 2, pra në pikën 3 themi “do të riprodhojë”, në lidhjen 2 themi video regjistrimi do të realizohet. Mendoni që gjuhësisht por dhe teknikisht duhet thënë do të riprodhohet, se video regjistrimi është bërë në vendet e numërit të votave, bëjmë fjalë gjithmonë kur do t’ja japid një subjekti sipas kërkesës së tij. Zoti Mezani, fjalë “do të riprodhojë” duhet këtu apo “do të realizohet”? Tek lidhja 2.

**Z.N.Mezani:** Video regjistrimi pavarësisht kohëzgjatjes do të realizohet në mediume dhe është do të riprodhohet propozimi. Lidhja 2 kemi pasur dhe diskutime të gjata, ndoshta **është e drejtë** të referohen 3 oferta që janë marrë.

**Znj.I.Nano:** Në akt themi do të riprodhojë administrata e KQZ-së, te lidhja themi video regjistrimi do të realizohet. Mendoni që shkon?

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Valbona Dushi*

*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.22.01.2021, ora 17:30*

**Z.N.Mezani:** Po, mund të shkojë do të riprodhohet, por në këtë rast ne kemi në kontekst titullin kosto e sherbimit administrativ do t'i japë asaj video regjistrimin. Pra meqë jemi në kontekst të titullit themi video regjistrimin pavarësisht kohëzgjatjes do të realizohet në mediumin... ky video regjistrim do të realizohet.... pra do të riprodhohet, nuk ka asnje problem. Faleminderit për ndërhyrjen!

**Znj.I.Nano:** Të nderuar kolegë propozimi im, nëse mund të quhet propozim apo korigjim le të themi, që të harmonizohet në fjalor, në leksikë sikundër e ka projektvendimi me lidhjen. Pra në qoftë se në projektvendim themi të riprodhojë, mendova që dhe në lidhje të themi të riporodhojë aty. Nuk e di a jeni dakord, duhet ta hedhim në votim këtë se mund të konsiderohet ndryshim.

**Z.M.Çakaj:** Edhe një herë propozimi..

**Znj.I.Nano:** Te lidhja 2 thuhet, video regjistrimi pavarësisht kohëzgjatjes do të realizohet në mediume, memorie, ruajtje informacion të jashtëm, ndërkohë në projektvendim thuhet administrata të riporodhojë kopje të materialit dhe pastaj sipas lidhjes 2. Unë mendova të harmonizojmë, pra ose do të themi të realizojmë në të dyja rastet ose themi të prodhohet. Megjithatë teknikisht është një gjë që e merr përsipër administrata.

**Z.M.Çakaj:** Kam përshtypje se është gjuhë teknike.

**Znj.I.Nano:** Prandaj ju drejtova teknikëve. Unë thjesht e mendova gjuhësish me gjithatë.

**Z.M.Çakaj:** Kam frikë se dalim te votimi i nenit 1, duke qenë se kemi dy lidhje totalisht teknike që me të drejtë zonja Vukaj propozoi të hartuar dhe të përgatitur nga administrata të paraqitur. Kështu që duke qenë ky projekt akt që po miratojmë

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Valbona Dushi*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisioni Rregulator*

*Dt.22.01.2021, ora 17:30*

ka dhe parametra teknik të dhëna teknike sigurisht ka dhe përllogaritje kosto metodologje të gjitha, të cilat në rastin konkret janë të përgatitur nga personat që kanë kanë njojuri të personalizuar në fushën përkatëse besoj se do të na duhej së bashku me sqarimin dhe ndryshimi apo shtesa që propozoi zonja Vukaj.

**Znj.I.Nano:** Unë e besoj po aq sa ju të njëjtën gjë, prandaj ju drejtova dhe dy zotërinjve.

**Znj.H.Vukaj:** Është e pamjaftueshme zonja Nano, qoftë dhe në këtë mbledhje që e konsiderojmë live e konsiderojmë në një nivel transparence, pra është e pamjaftueshme pa atë shprehjen që unë sugjerova në fillim dhe sikundër është një nga ato akte, i cili ka një përbajtje të lartë teknike, pra flet me terma teknik përvec atyre 4 pikave që bëjnë interlokucionin me lidhjen 1 dhe 2.

Unë e kam parë të domosdoshme dhe nivelin e garancisë dhe ndaj propozova ato 2 pika, ato 2 shtojca ose ato dy togfjalësha, sepse teknika legjislative është larg në optikën tonë të të bërit akte në këtë moment kur të gjithë palët kërkojnë garanci të shtuara për më tepër për proces zgjedhor i cili është anatemuar në 100 forma. Tashmë votimi juaj kaloi për pikën 1, për sa i përket lidhjes por ky ishte një sqarim i nevojshëm ndoshta i dubluar, për të mos parë ndonjë herë aq shumë teknikën legjislative sesa garancinë që do t'ia ofrojmë publikut.

**Znj.I.Nano:** Faleminderit zonja Vukaj!

Propozimi im është që tek lidhja 2 fjalia e parë: fjala “do të realizohet” të zëvendësohet “do të riprodhohet”.

**Kush është dakord me këtë propozim?**

**Pro:** 3 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka,)

**Kundër:** 2 (znj.Vukaj, z.Çakaj).

Nuk miratohet.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Valbona Dushi*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregullator  
Dt.22.01.2021, ora 17:30*

**Znj.I.Nano:** Atëherë kalojmë në miratimin, meqënëse kishim një propozim që u rrëzua, miratimin e pikës së 3-të bashkë me lidhjen dy.

**Kush është dakord me pikën 3 të projekt vendimit bashkë me lidhjen 2 ju lutem?**  
Ndjesë z.Çaka?

**Z.M.Çakaj:** Të ndryshuar, sipas propozimit të Z.Çaka, KZAZ, pika 3.

**Znj.I.Nano:** Atëherë 3 vota jemi pro?

**Z.D.Çaka:** 4 pra, si 3?

**Znj.I.Nano:** 4 pro.

**Z.D.Çaka:** 4 të ndryshuar, 5 pasi dhe znj.Vukaj nuk e votoi. Më fal edhe njëherë ta sqarojmë!

**Znj.I.Nano:** Znj.Vukaj e votoi kundër, tashmë e votoi në tërësi, pasi u rrëzua edhe një propozim, kemi vetëm një ndryshim të propozuar dhe të miratuar nga z.Çaka, propozuar nga z.Çaka, të miratuar me 4 vota, për shkak se pati dhe një propozim tjetër u rrëzua unë po e votoj edhe njëherë pikën 3 në tërësi mbas këtyrë diskutime, ku përfshihet vetëm propozimi i votuar i z.Çaka dhe jemi 4 përsëri?

**Z.M.Çakaj:** 4.

**Znj.I.Nano:** Dakord. Znj.Vukaj kundër? Faleminderit!

Pika 3 miratohet me një ndryshim me 4 vota pro 1 kundër.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Romina Kokoshi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.22.01.2021, ora 17:30*

**Pro:** 4 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, z.Çakaj)

**Kundër:** 1 (znj.Vukaj)

Atëherë pika 4 e projekt vendimit. Afati i ruajtjes së materialit të regjistruar, të jetë deri në përfundim të verifikimit pas zgjedhor të sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë informatike ose deri në hapjen e kutive. Po znj.Vukaj?

**Znj.H.Vukaj:** Meqënëse e çela siparin kur ju na dhatë fjalën për të diskutuar në parim dhe konsiderova që ky akt është i rëndësishëm për faktin se, ky material i regjistruar elektronik apo filmik do të shërbejë si provë e pa kontestueshme në të gjitha format, sepse është vizualisht i tillë. Atëherë këtu në pikën 4 kam një propozim të ri, për ta ndarë në 2 momente dhe në 2 fazë duke ju referuar gjithashtu edhe ligjit për Arkivat e Shtetit, por njëkohësisht edhe nenit 178 të Kodit Zgjedhor. Më lejoni ta lexoj?

**Znj.I.Nano:** Po!

**Znj.H.Vukaj:** Atëherë, afati i ruajtjes së materialit të regjistruar nga kamerat në VNV, në KQZ të jetë deri në përfundim të verifikimit pas zgjedhor të sistemeve, apo pajisjeve të teknologjisë informatike ose deri në hapjen e kutive. Pas kalimit të këtij afati, regjistrimi filmik dërgohet në Arkivin Qendror të Shtetit, në përputhje me parashikimet e nenit 178, pika 6 të Kodit Zgjedhor. Ky është dhe propozimi im.

**Znj.I.Nano:** Atëherë në fjalinë e parë ju propozoni të shtojmë materiale të regjistruar nga kamerat në VNV?

*Zbardhi materialin e incizuar  
Romina Kokoshi*

*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisioni Rregulator*

*Dt.22.01.2021, ora 17:30*

**Znj.H.Vukaj:** Afati i ruajtjes së materialit të regjistruar nga kamerat në VNV, në KQZ të jetë deri në përfundim të verifikimit pra ashtu siç është, deri në mbyllje të kësaj fjalie. Fjalia mbylljet me fjalën e kutive. Fjalia e re që shtohet pas kësaj është, pas kalimit Pas kalimit të këtij afati, regjistrimi filmik dërgohet në Arkivin Qendror të Shtetit, në përputhje me parashikimet e nenit 178, pika 6 të Kodit Zgjedhor ose për teknikë legjislative në përputhje me parashikimet e pikës 6 nenit 178 të Kodit Zgjedhor.

**Znj.I.Nano:** Mirë, kolegë, diskutime, propozime të tjera për këtë pikë?

**Znj.H.Vukaj:** 178 nenit.

**Znj.I.Nano:** 178 nenit, pika 6. Po. Përfaqësuesit e partive politike u ri kthyen. Z.Gjokuta?

**Z.P.Gjokuta:** Logjika e propozuar nga znj.Vukaj, është e drejtë edhe ligjore dhe teknike, vetëm desha të sqaroj një gjë që ndoshta duhet ta keni parasysh. Kemi 2 gjëra materiale filmike është një origjinal është dhe një kopje. Origjinali është i regjistruar në një format që është në pajisjen e kompanisë që bën shërbimin. Të gjitha ato që u thanë, për ti marrë kopje dhe për t'ua dhënë subjekteve që i kërkojnë, janë kopjet e atij materiali. Cili do të jetë ajo që do të shkojë. Cila do të jetë, domethënë do të jetë origjinali, apo do të jetë kopja që do të shkojë në Arkivën e Shtetit? Kjo duhet svaruar në akt mendoj unë,

**Znj.I.Nano:** Pa diskutim që është origjinali, dhe ai është materiali primar i administruar.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Romina Kokoshi*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.22.01.2021, ora 17:30*

**Z.P.Gjokuta:** Më fal,në qoftë se është vënë afat,

**Z.N.Mezani:** Znj.Nano, A mund të ndërhyj pak?

**Znj.I.Nano:** Po Z.Mezani? Ja një moment,

**Z.P.Gjokuta:** Në qoftë se është vënë afati i ruajtjes,disi i ngushtë është vënë përfaktin që ato pajisjet në kontratën që bën KQZ-ja me operatorin, në një moment të caktuar se operatori i ka pronë se mund të lihej psh deri në zgjedhjet e ardhshme, po të ishin kopje ato kopjet që mban KQZ-ja në pajisjet e veta, i mban deri në zgjedhjet e ardhshme sepse i duhet ti lirojë ato pajisje përmaterialin e zgjedhjes, prandaj duhet caktuar, kush duhet të shkojë, dhe që të shkojë ajo që është origjinale atje duhet të shkojë me pajisjen e kompanisë, ndërsa nuk e di nga ana teknike e vërtetuar që është një me origjinalin, përmendimin tim ajo duhet të shkojë në Arkivë dhe janë pajisje sic paraqitet në lidhjen 2, janë pajisje 2 terabite që në varësi të orëve që regjistrohet në një vend numërimi mund të jetë dhe më shumë se një. Sidoqoftë nëse, përderisa e ka ligji i Arkivës ato do bëhen sado pajisje të jenë po logjika sa e marr vesh unë nga kjo është që do të shkojë kopja në arkivë dhe do cilësuar në akt.

**Znj.I.Nano:** Po z.Mezani, ju lutem ?

**Z.N.Mezani:** Më fal që po ndërhyj unë, nga pikëpamja inxhinierike, të gjithë anëtarët e komisionit, kopje dhe origjinal në konceptin kur vjen një subjekt dhe i jepet një kopje ajo është njësoj si origjinali. Nuk ekziston kopje dhe origjinal si një

*Zbardhi materialin e incizuar  
Romina Kokoshi*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.22.01.2021, ora 17:30*

fletë protokolli. Në gjuhën elektronike, informacioni, përmbajtja, video që vjen nga VNV-ja dhe është në formatin që ne do dëshirojmë ta marrim dhe e kemi përcaktuar në akt dhe me atë format nuk ka rëndësi, çon makinën e kompanisë apo çon një flash memory të jashtme në, është i njëjtë përmbajtje dhe nëqoftëse futet termi kopje ose origjinal, e vë në diskurs shumë të madh çështjen nëse e mer një subjekt materialin. Materiali është një dhe i vetëm nuk ka as kopje dhe as origjinal, përmbajta është po ai, ne e mirë përcaktuam numrin e tavolinës, numrin e VNV-së dhe këtu nuk është koncepti kopje dhe origjinal nuk është nuk është një dokument në protokoll nga pikëpamja inxhinierike. Filmimi është material inxhinierik, elektronik, video, është ai dëshironi të ruani një kopje në arkiv,

**Znj.I.Nano:** Z.Mezani, unë mendoj që Znj.Vukaj nuk kishte qasjen tekniqe por kishte merakun e transpozimit të saktë të nenit 178 të Kodit Zgjedhor. Z.Mezani, Faleminderit!

**Z.N.Mezani:** Faleminderit ju!

**Znj.I.Nano:** Mendoj që znj.Vukaj, ndjesë znj.Vukaj, jo se po flas në emrin tuaj, mendo që meraku më tepër i juaj por besoj edhe i joni është transpozimi i 178/6, për dorëzimin në Arkivin e Shtetit, sipas afateve që janë përcaktuar dhe në Kod apo jo?

**Znj.H.Vukaj:** Pikërisht, por ndërhyrja që bëri z.Mezani, ishte e drejtë në kuptimin e zbërrthimit inxhinierik të kësaj prove, pra përmbajtjes, të kontentit sic e tha ai, pra në momentin kur ne qartësohemi me faktin që KQZ, këtë përmbajtjen e bën të sajin dhe nuk ka dallim mes origjinalit dhe kopjes sepse nuk është e shkruar apo e

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Romina Kokoshi*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisioni Rregulator*

*Dt.22.01.2021, ora 17:30*

fotokopjuar por është dokument i ri prodhuar në gjuhën teknike z.Mezani ndoshta nuk gaboj apo gaboj, më ndërhyjni ju, pra nëqoftëse KQZ-ja arrin ta bëjë të sajin këtë përtej regjistrimit dhe kontenit që ka kompania, atëherë ky material i KQZ-së, pra që konsiderohet domeni i KQZ-së, nevojitet që të shkojë përtej afatit në KQZ-së, të shkojë të arkivohet dhe të ruhet sipas ligjit për Arkivat, apo jo Z.Mezani, jam e qartë te kjo?

**Z.N.Mezani:** Domethënë, ideja është shumë e thjeshtë, unë ndërhyra vetëm për çështjen që në gjuhën elektronike, origjinal me kopje kur flasim për të njëjtën përmbajtje nuk vlen origjinal apo kopje, është po ajo përmbajtje, ka atë regjistrim, ka atë orar, ka atë format ka atë madhësi, nuk dikutohet është një një memorie x, apo është një memorie y, kontenti,

**Znj.H.Vukaj:** KQZ-ja i ka të vetat këto pajisje apo i ka të prokuruara, thjesht për momentin?

**Z.N.Mezani:** Procedura është e tillë, që është e vërtetë ajo që ju thatë pak më parë, që është shumë e vështirë që ZAZ-ja të shohë një kopje gjatë kohës që, por në momentin që vjen këtu brenda afateve të para caktuara, ajo konsiderohet pronë e KQZ-së dhe është në dispozicion të çdo subjekti. Përtej afateve nëqoftëse vendoset në Arkivën e Shtetit, nuk ka asnjë problem, neve ruajmë normalisht edhe përtej afateve të përcaktuara nga Kodi.

**Z.Y.Merkaj:** Më fal znj.Nano,a mund të bëj një ndërhyrje?

**Znj.I.Nano:** Po?

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Romina Kokoshi*

*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.22.01.2021, ora 17:30*

**Z.Y.Merkaj:** Kam përshtypjen se Arkiva e Shtetit mban vetëm anën dokumentare dhe nuk mban, nuk ruan dokumenta në usb apo disk, mesa di unë.

**Znj.I.Nano:** Në fakt po të transpozojmë saktësisht z.Merkaj, 178/6 të Kodit Zgjedhor, ja dërgon ato Arkivit të Shtetit në mënyrën e caktuar prej tij, pra është Arkiva e Shtetit që cakton mënyrën sesi do të ruhet.

**Z.Y.Merkaj:** Po besoj ka vetëm anën dokumentare, ka proces verbalet e votimit tabelat e rezultatit, ka dhe,..

**Z.I.Kaso, përfaqësuesi i PD-së:** Mundem një koment?

**Znj.I.Nano:** Po z.Kaso?

**Z.I.Kaso, përfaqësuesi i PD-së:** Faleminderit e nderuar! Përsa i përket shqetësimit që ngriti z.Merkaj, kam përshtypjen që Arkiva e Shtetit disponon materiale, në,..

**Znj.I.Nano:** Z.Kaso, ndoshta keni një problem me internetin?

**Z.N.Mezani:** Znj.Nano, a mund të bëj një ndërhyrje?

**Znj.I.Nano:** Po patjetër z.Mezani, vetëm sa të mbarojë z.Kaso, ju lutem! Ndoshta Z.Kaso kishit një problem me internetin?

*Zbardhi materialin e incizuar  
Romina Kokoshi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.22.01.2021, ora 17:30*

**Z.I.Kaso, përfaqësuesi i PD-së:** Nuk u dëgjua?

**Znj.I.Nano:** Jo nuk u dëgjua, pra e nisët me shqetësimin e paraqitur nga Z.Merkaj.

**Z.I.Kaso, përfaqësuesi i PD-së:** Besoj që që Arkiva e Shtetit disponon në fondin e saj materiale të shumëlojshme, përveç atyre dokumentarë, edhe mikro filma dhe cd filmike pra të gjitha llojet e materialeve dhe nuk besoj që përbën problem në këtë aspekt dërgimi i materialit pranë Arkivës së Shtetit, por dhe në rast se do të ishte do të duhej që mbasi KQZ-ja ta dërgonte të ishte Arkiva e Shtetit që të saktësonte që ky material nuk mund të merrej në ruajtje për një, dy, tre, pesë shkaqe. Përveç faktit që mbështesim propozimin e znj.Vukaj, e gjej me vend dhe në respektim të dispozitës ligjore që citoi, besoj që shpjegimi që që administrata dha ngre një shqetësim tjetër, nga sa u kuptua materialet ose të paktën praktikë e deri tanishme e bashkë veprimit të KQZ-së, me kompani që ofron këtë shërbim ka qenë që pajisjet të mbeten në pronësi të kompanisë dhe një kopje ose një kontent, ajo të cilët Z.Gjokutaj ju referua si origjinale mbetet brenda pajisjeve, çka do të parashtronë nevojën e rregullimit tuaj edhe të këtij aspekti. Pra një kontent që pajisjet kanë brenda vihet në dispozicion të KQZ-së, që kuptohet nga akti dhe nga praktika, i cili e bën të vetën dhe nëqoftëse ka kërkesa nga subjektet, ua vë në dispozicion atyre dhe në rast të kundërt e ruan deri në zgjedhjet e ardhshme, ose do ta çojë nëqoftëse ju bini dakord në Arkivën e Shtetit. Ndërkohë duhet normuar edhe pjesa tjetër e përbajtjes që ngelet në pajisjet e operatorit nëqoftëse kontrata përkatëse nuk e normon këtë, por besoj që nuk është më shumë çështje kontrate,

**Z.M.Çakaj:** Më fal,

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Romina Kokoshi*

*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisioni Rregulator*

*Dt.22.01.2021, ora 17:30*

**Znj.I.Nano:** Po z.Çakaj, edhe unë do të doja të thoja diçka por ju lutem ju atëherë, z.Kaso ka probleme me internetin, mesa duket dhe nuk arriti ta përfundonte. Po z.Çakaj?

**Z.I.Kaso, përfaqësuesi i PD-së:** Të shkatërrohet, pasi nuk mund ti lihet një operatori privat, përbajtja serioze siç është filmimi i çdo flete votimi që kanë hedhur Shqiptarët. Faleminderit!

**Znj.I.Nano:** Po z.Çakaj?

**Z.M.Çakaj:** Atëherë, referuar relacionit të paraqitur nga administrata e KQZ-së, si dhe referuar nenit 22, paragrafi 2 të Kodit Zgjedhor, ku parashikohet se KQZ-ja ka kompetencë të instalojë dhe përdorë sisteme video monitorimi në qendrat e votimit, si dhe kur bëhet numërimi manual i votave në VNV, për të monitoruar dhe provuar rregullshmërinë e procesit në mjediset e brendshme të tyre, nëse nuk e kryen vetë, KQZ-ja ka të drejtë të prokurojë instalimin ose edhe operimin e sistemit të video monitorimit. Në gjykimin tim lidhur edhe me njohuritë që kam unë në fushën e prokurimit, unë besoj se është e zgjidhur ligjërisht kjo, në çfarë do lloj rrethane, që KQZ-ja do të prokurojë, qoftë shërbimin, qoftë mallin, objekt kontrate, në të gjitha versionet, kjo është pra video regjistrimi, është në të gjitha versionet pronë e KQZ-së. Edhe nëse KQZ-ja e merr me qera këtë, pavarësisht se neni 22 i ligjit e ka qartësuar, që do të thotë e prokuron, e prokuron do të thotë blen, ose mallin ose shërbimin, nga na tjetër ligji i prokurimit e ka përjashtuar në mënyrë të qartë prokurimin nga qeraja, kështu që unë besoj në të gjitha versionet, materiali filmik i prodhuar është dhe do të ngelet pronë e KQZ-së. Mënyra e administrimit pastaj, unë e gjej me vend propozimin e Znj.Vukaj, që duke patur parasysh që materiali filmik trajtohet njësoj si materialet zgjedhore atëherë sigurisht që nuk e gjej me vend atë diskutimin që bëri z.Merkaj ne lidhje me

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Romina Kokoshi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisioni Rregulator*

*Dt.22.01.2021, ora 17:30*

pamundësinë e arkivimit në Arkivin Qendror. Sigurisht që Arkivi Qendror i mundëson të gjithë formatet e ndryshme, qoftë filmike, qoftë dokumentare, qoftë cd, i mundëson. Nga ana tjetër ky material filmik është dhe do të ngelet gjithmonë në pronësi të entit prokurues që në rastin konkret është KQZ-ja. Nuk ka rëndësi pajisja neve na intereson produkti. Produkti është i KQZ-së dhe në këtë aspekt edhe me deklarimin që bëri personi përgjegjës, apo personi që ka njohuri specifike z.Mezani, në fushën e Teknologji-Informacionit, jam dakord dhe me të, pra përfekt prove, përfekt edhe unifikimi nuk mund të ketë një material origjinal apo një apo më shumë kopje. Materiali origjinal është një dhe i vetëm dhe ai administrohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, kështu që,

**Znj.I.Nano:** Z.Çakaj Faleminderit! Kam edhe unë një koment, lidhur me gjithë këtë diskutim që po bëjmë. Unë do ti rikthehesha fillimit të mbledhjes dhe do të ri sillja në vëmendjen e të gjithëve titullin e aktit që po miratojmë. Nuk mendoj se pretendojmë që me një akt, do të zgjidhim gjithë problematikat e procesit zgjedhor. Ky akt ka përf qëllim, ja kemi vënë vetë detyrë vetes, që në dhjetor kur kemi miratuar vendimin numër 8, kemi thënë që me akt normativ do të miratojmë rregullat proceduriale të përdorimit të videove monitoruese, regjistruese, ekraneve, në vendet e numërimit të votave dhe transmetimin e tyre në KQZ. A mendoni se është vendi që ne duke diskutuar këtë akt, të vlerësojmë gjithë etapat e procesit zgjedhor?

**Z.M.Çakaj:** Po sigurisht, më fal, po sigurisht, të lutem,

**Znj.I.Nano:** Unë mendoj që jo,

**Z.M.Çakaj:** Çfarë kuptimi ka që ne vendosim kamerat në VNV dhe nuk ruajmë materialin, pse do prodhojmë filma ne?

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Romina Kokoshi*

*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.22.01.2021, ora 17:30*

**Znj. I.Nano:** Nuk po flas pér atë zoti Cakaj, sigurisht që ne ruajtjen e materjalit dhe afatin e ruajtjeve e kemi dhe në këtë akt dhe e ka dhe në Kodin Zgjedhor. Mua më duket e tepërt pér sa i përket këtij akti dhe këtij diskutimi.

**Z.M.Çakaj:** Unë ju citova besoj se e kemi lexuar të gjithë relacionin e paraqitur nga Administrata e KQZ-së paragrafi 3 si dhe nenin 22 të Kodit Zgjedhor e cila autorizon edhe Komisionin Rregulator ku ne bëjmë pjesë të miratojmë këtë akt normativ. Unë e gjej shumë veten dhe shqetësimin e paraqitur nga zoti Kaso dhe në këtë kontest bëra atë diskutimin që materiali filmik është një dhe i vetëm nuk ka disa origjinal apo kopje ai është original dhe ai administrohet nga KQZ-ja dhe sigurisht ruhet sipas parashikimeve të nenit 178 pika 6.

**Znj.I.Nano:** Këtë jemi duke thënë biem të gjithë dakord me këtë pjesë..

**Z.M.Çakaj:** Shqetësimi lindi me diskutimin që bëri zoti Gjokutaj, sepse ajo është vërtet shqetësuese. Nëse materiali filmik në gjykimin tim personal është totalisht shqetësuese. Nëse materiali filmik prodhohet nga kompania dhe rri te kompania se mund të ketë kosto aparatura apo jo. Materiali filmik është pronë e Komisionit Qendorr të Zgjedhjeve në të gjitha rr Ethanat. Të jemi të qartë pér këtë pikë.

**Znj.I.Nano:** Do të rikthehem i te propozimi i zonjës Vukaj?

Ka dy propozime ka një tek fjalia e parë.

Zoti Mezani unë mendoj se tashmë kjo nuk është më cështje teknike, po flasim pér afat ruajtje dhe dorëzim në Arkivin Qëndror të Shtetit.



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.22.01.2021, ora 17:30*

**Znj. H.Vukaj:** Zoti Mezani mund ta bëjë sqarimin zonja Nano, për efekt të asaj që u hap si diskutim pra origjinali dhe kopja. Dua të bëj dhe një sqarim tjetër për efekt të mediave që po na ndjekin dhe publikut që ka një lloj pritshmërie.

**Znj.I.Nano:** Zoti Mezani fjala për ju.

Jemi duke shqyrtuar pikën 4 të projektvendimit “afati i ruajtjes”.

**Z.N.Mezani:** Në qoftë se dispozita ligjore nuk parashikon që në Arkivin e Shtetit të ruhen kodet filmike të një procesi të numërimit të votave, ju keni të drejtën që ta votoni dhe të shton “ruajtjen e informacionit” në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve mund ta tërhiqni kur të dëshironi. Por nëse dëshironi ta ruani në Arkivën e Shtetit mund ta ruani po ne e kemi ruajtur këtë informacion edhe pse kanë kaluar afatet kohore të parashikuara në ligj domethënë drejtoria teknike. Për të sqaruar zotin Kaso në cdo kontratë përvec veprimeve që ka kompania për të kryer atë shërbim transmetimin live njëkohësisht kompania ka detyrimin që kontekstin video e ka në dispozicion të KQZ-së dhe cdo kontent video i makinave “kompjuter” që ruhet fshihet e ka detyrim ligjor që ta fshijë pasi kryen këtë proces dhe jo rastësisht KQZ-ja përcakton format, sepse kompania mund ta ruajë në formate të ndryshme në kompjutera ne kërkojmë një format 94 ose në një format tjetër të lexueshëm lehtësisht pra janë të paracaktuara. Kjo ishte thjesht për sqarim dhe për të pasur një ide më të qartë rrith këtij procesi.

**Znj.I.Nano:** Faleminderit zoti Mezani. Kam një pyetje keni qenë pjesë e procesit të e hartimit të këtij akti drejtoria juaj? Jemi duke folur për pikën 4 të projektaktit që lidhet me afatin e ruajtjes dhe dorëzimin në Arkivë sipas 178 6. Unë nuk e di nëse kanë vend teknikalitetet aty, unë personalisht por dhe gjithë kolegët ju drejtuam.



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisioneri Rregulator*

*Dt.22.01.2021, ora 17:30*

Kemi propozimin e zonjës Vukaj, për një shtesë në fjalinë e parë të pikës 4 “afati i ruajtjes së materjalit të regjistruar nga kamerat e VNV në KQZ. Pra fjalia e parë afati i ruajtjes së materjalit të regjistruar nga kamerat e VNV, në KQZ të jetë deri në përfundim të verifikimit pas zgjedhor të sistemeve apo pajisjeve teknologjisë informatike deri në hapjen e kutive.

Votojmë propozimin e parë ju lutem.

***Kush është dakord me shtesat që ka propozuar zonja Vukaj?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S'ka***

Miratohet fjalia e parë e pikës 4 me shtesat e propozuara nga zonja Vukaj.

Zonja Vukaj mund të lexoni fjalinë e dytë që ju propozoni të shtonit?

***Znj.H.Vukaj:*** Pas kalimit të këtij afati regjistrimi filmik dërgohet në Arkivin Qendror të Shtetit në përputhje me parashikimet e nenit 178 pika 6 të Kodit Zgjedhor.

***Znj.I.Nano:*** Kam dhe unë një propozim, pra zonja Vukaj thotë, pas kalimit të këtij afati regjistrimi dërgohet në Arkivin Qendror të Shtetit...

***Znj.H.Vukaj:*** Duke u referuar pikës 2 për të qenë në unison me pikën 2 ku thuhet regjistrimi filmik atëherë jam përbajtur këtij konteksti për ta sjellë te pika 4.

***Znj.I.Nano:*** Votojmë propozimin e zonjës Vukaj për të shtuar një fjali të dytë në pikën 4 të këtij projektvendimi.

Kush është pro?

***Pro: 2 (znj.Vukaj, z.Çakaj)***



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.22.01.2021, ora 17:30*

*Kundër: 3 (zpj.Nano, z.Çela, z.Çaka)*

*Nuk miratohet* shtesa e propozuar nga zonja Vukaj fjalia e dytë e pikës 4.

**Znj.H.Vukaj:** Është totalisht e precedent nuk do të thoja fjalën i rrezikshëm ky, sepse po japim shqiptarëve një pamundësi për të pasur një dokument më tutje në Arkivën e Shtetit. Pra po i lemë një afat kaq të shkurtër ndërkohë që zgjedhjet apo proceset zgjedhore të mëparshme kanë demostruar që kanë dalë indicie dhe procese në ndjekje edhe pas këtyre afateve të specifikuara prej 6 muajsh apo prej një afati kohor jo optimal. Kështu që vota është e juaja mendimi i juaji po këtë shtesë e gjeja me vend që ta paraqes ul integritetin e aktit dhe sigurinë e aktit dhe dokumentave. E ndjej shumë të rëndësishme se është dokument i rëndësishëm.

**Znj.I.Nano:** Ka një parashikim në nenin 178 pika 6 të Kodit Zgjedhor që në fakt përfshin më tepër sesa këtë materjal, të gjithë materjalet zgjedhore dhe cfarë bëhet me to pas kalimit të një afati, të cilat asgjesohen dhe të cilat dërgohen në Arkivën e Shtetit kështu që unë mendoj se është një merak i zgjidhur. Atëherë kemi pikën 5 të këtij vendimi, ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare.

**Z.M.Çakaj:** Ju lutem se nuk kemi mbaruar me pikën 4, duhet të kaloni votimin e pikës 4 në tërësi sipas ndryshimit të pikës 1 dhe mos miratimin e ndryshimit pikës 2, kështu e ka rregullorja e organizimit të funksionimit te Komisionit Rregulator.

**Znj.I.Nano:** Atëherë deri në këtë moment kemi pasur dy propozime njëri prej tyre është miratuar, propozimi i dytë është rrëzuar.



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.22.01.2021, ora 17:30*

Votojmë në tërësi pikën 4 me ndryshimet e miratuara deri tani sipas propozimit të zonjës Vukaj për fjalinë e parë.

**Kush është dakord me tekstin e pikës 4 me ndryshimet e votuara?**

**Pro:** 3 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka)

**Kundër:** 2 (znj.Vukaj, z.Çakaj)

Atëherë pika 4 e projektvendimit nuk miratohet.

Vijojmë me pikën 5 ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

**Kush është dakord me pikën 5?**

**Pro:** 3 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka)

**Kundër:** 2 (znj.Vukaj, z.Çakaj)

Nuk miratohet.

Pika 6, kundër këtij vendimi mund të bëhet në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë brenda 5 ditëve nga shpallja.

Ka ndonjë propozim për ndonjë shtesë apo ndryshim?

**Z.M.Çakaj:** Kisha një diskutim edhe për pikën 5 meqë nuk e parashtruat për diskutim e bëj tani te pika 6.

**Znj.I.Nano:** Nuk ka nevojë për diskutim hyrja në fuqi menjëherë, janë dy dispozitat e fundit që zakonisht nuk ka pasur shtesa apo ndryshime sepse normalisht nuk mund të ketë gjithsesi po ju ndjek.

**Z.M.Çakaj:** I rikthehem i dhe një herë diskutimit edhe unë e gjej shumë të rëndësishme diskutimin dhe propozimin konkret që bëri zonja Vukaj. Në të gjithë tërësinë e këtij akti nëse ne parashikojmë rrëgullat proceduriale karakteristikat teknike miratojmë dhe tarifa për regjistrimin filmik video të



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisioni Rregulator*

*Dt.22.01.2021, ora 17:30*

procesit të numërimit të votave nisur dhe nga konteksti politik i zgjedhjeve i disa pak zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë. Unë mendoj se nuk ka asnje vlerë juridike nëse ne miratojmë rregullat procedurale për përdorimin e kamerave, miratojmë karakteristikat teknike. Në lidhjen 2 miratojmë masën apo metodologjinë e shpërndarjes së këtij materiali filmik për **palët** e interesuara, ndërkohë që ne nuk miratojmë parashikimin kryesor. Fakti që ky material ruhet kemi dy momente ruajtjes së pari në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve dhe së dyti pas mbarimit të afatit të ruajtjes në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve që lidhet ngushtësisht me përfundimin e verifikimit pas zgjedhor të sistemeve, apo pajisjeve, ndërkohë ne nuk e japim rëndësinë këtij materiali dhe ta ruajmë në Arkivin Qëndror të Shtetit. Cfarë ndodh në një situatë hipotetike? Nëse një organ procedures për nevoja të hetimit penal sigurisht do të kërkoj materialin filmik origjinal. Ne ndërkohë nuk e disponojmë në KQZ, ne këtë akt po e lemë në mëshirë të fatit materialin filmik dhe kjo në gjykimin tim e humbet komplet vlerën të gjithë aktit. Më fal cfarë po miratojmë ne këtu rregullat për prokurimin e video regjistrimit e sistemit të video regjistrimit në VNV? Të jetë kaq mikapikëse kamera apo të jetë kaq **frenç** për sekondë? Nuk ka kuptim kjo të miratojmë të gjithë këto rregulla teknike apo të jetë 360 gradë? Ndërkohë që ne nuk miratojmë momentin kryesor procedural dhe karakterin normativ të këtij akti. Për cfarë duhet ky akt, shërben si një instrument transparent për të gjitha palët? Nëse ne nuk parashikojmë sesi do të ruhet ky material filmik cfarë kemi bërë konkretisht? Pra kemi miratuar parametrat teknik sesi do të bëhet prokurohet kjo. Në gjykimin tim nuk jam dakord ta miratojmë në tërsi po nuk rregulluam mënyrën sesi administrohen këto do të ruhen. Ky është momenti më thelbësor i këtij akti. Nga ana tjetër nuk parashikohet asgjékundi zonja Nano në Kodin Zgjedhor as në atë ligjore se materiali filmik barazohet me materiale zgjedhore. Nëse ju e gjeni në një vend të shkruar në Kodin



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.22.01.2021, ora 17:30*

Zgjedhor, unë jam dakord ta miratojmë. Por nuk parashikohet asgjékundi që materiali filmik video e regjistruar në VNV të ketë të njëjtën vlerë apo të barazohet dhe në trajtim me materialet zgjedhore. Faleminderit!

**Znj.I.Nano:** Faleminderit zoti Çakaj! Unë mendoj se kjo është pjesë e diskutimit të menjëhershme dhe zonja Vukaj referencën e saj e pati te neni 178 pika 6, në propozimin e saj dhe ky nen flet për kuti votimi procesverbale, tabela procesverbal i numrit të votimit dhe dokumentacioni që ndodhet në kutitë e materialeve të votimit. Atëherë në qoftë se nuk ka referencë tjetër si mund ta shtojmë një dispozitë të tillë ju lutem? Referenca është neni 178 pika 6.

**Z.M.Çakaj:** Ju keni propozim konkret se ju sikur do të bëni një propozim konkret? A jeni dakord që të ruhet?

**Znj.I.Nano:** Të ruhet sipas parashikimeve të nenit 178 pika 6 unë e bëra propozimin.

**Z.M.Çakaj:** Dakord e heqim propozimin e nenit 178 meqë ju duket me vend.

**Znj.I.Nano:** Jo unë e bëra sipas nenit 178 pika 6 nuk shtova material filmik e të tjera, por ruajtja, sepse në pikën e parë ke afatin e ruajtjes.

**Z.M.Çakaj:** Më fal sa biem ne dakord që të ruhet deri në verifikim 3 muaj, 6 muaj, 1 muaj?

**Znj.I.Nano:** Neni 178 pika 6 ka 6 muaj më pas.



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.22.01.2021, ora 17:30*

**Z.M.Çakaj:** Në gjykimin tuaj materiali filmik barazohet me fletët e votimit që asgjësohen.

**Znj.I.Nano:** E keni pyetjen për mua?

**Z.M.Çakaj:** Për ju zonja Nano, bashkë po diskutojmë.


**Znj.I.Nano:** Duhet ti drejtoheni zonjës Vukaj që referoi së pari te neni 178 pika 6.

**Znj.H.Vukaj:** Jam shumë e qartë me çfarë kam referuar, kështu që si një material i cili mbahet të njëjtën vlerë. Ne po bëjmë fjalë që të ruhen procesverbale dhe dokumenta formal procedural të KAZA-ve apo të qendrave të votimit jo më për materiale filmike të cilat sjellin në mënyrë transparente cfarë do lloj ndërhyrje apo cfarë do lloj kapje që mund t'ju bëhen numëruar.

**Znj.I.Nano:** Po flasim për një proces post, nuk po flasim për numëruarit në atë kohë.

**Znj.H.Vukaj:** Po flasim për verifikimin që bëjnë kamerat, për transparencën e shtuar në këtë proces dhe atë risinë që përmendi zoti sekretar i përgjithshëm në krye të herës. Ne nuk jemi këtu për të certifikuar megapikset apo parametra të tjera apo vlerën e një dokumenti dhe orët e punës.

**Znj.I.Nano:** Në fakt këtë duhet t'ia themi ligjvënësit sepse është ligjvënësi që na ka ngarkuar me hartimin e projektakteve të kësaj natyre me karakter normativ edhe për këto cështje.



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.22.01.2021, ora 17:30*

**Znj.H.Vukaj:** Precedenti është krijuar në këtë vend me zgjedhjet dhe me ndërhyrjet në procese zgjedhore nuk e di ku e gjeni forcën dhe argumentin që këtë dokument t'i jepni një vlerë minimalistë si të ishte një fletë e bardhë apo një fletë shënimesh. Është një dokument shumë i rëndësishëm dhe duhet ruajtur në Arkivën e Shtetit dhe i mbetem propozimit që në krye të herës. Rishikoheni edhe një herë qoftë dhe një propozim të ri apo nëse nuk ju pëlqen togfjalëshi apo formulimi gjuhësor, por baza ligjore është e sigurtë.

**Znj.I.Nano:** Ka ndonjë propozim tjetër?

**Z.M.Çakaj:** Dakord e bëj unë një propozim për nenin 4, pas kalimit të këtij afati regjistrimi filmik ruhet në Arkivin Qëndror të Shtetit sipas ligjit për arkivat. Po për këtë jeni dakord?

**Znj.I.Nano:** Unë dua t'i referohem në mënyrë korrekte ligjit, ndaj e përmenda nenin 178 pika 6, sepse thotë në Arkivin Qëndror të Shtetit në mënyrën e caktuar prej tij prej Arkivit. Prandaj doja t'i referoheshim nenit 178 pika 6 pa hyrë në detaje.

**Z.M.Çakaj:** Ku e gjeni pa vend ju? Ku qëndron mospërputhja e propozimit të zonjës Vukaj me nenin 178 pika 6?

**Znj.I.Nano:** Dorëzimi në Arkivë bëhet sipas kërkesave mënyrës së caktuar nga arkivi thotë Kodi Zgjedhor dhe unë këtë pjesë nuk dua që ta prek. Nuk mund të bëj interpretime të Kodit Zgjedhor apo t'i zbatoj ndryshe.



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.22.01.2021, ora 17:30*

Prandaj po të përmendim ligjin për Arkivat është tjetër gjë, po të përmendim Kodin Zgjedhor ne si organ drejtues i Komisionit Qendoror të Zgjedhjeve kemi detyrën të zbatojmë Kodin Zgjedhor.

**Z.M.Çakaj:** A jemi dakord që materiali filmik do të ruhet pas mbarimit të verifikimit paszgjedhor? Nëse nuk jemi dakord për këtë është e kotë cdo propozim.

**Znj.I.Nano:** Kam një pyetje për administratën e KQZ-së që ky nen sapo lexoj është që nga viti 2012, hyn në fuqi kështu që çfarë ka ndodhur që nga viti 2012 deri në 2020?

**Znj.H.Vukaj:** Zonja Nano nuk mund t'i adresohem administratës për këtë pikë e cila është e qartë për ne si juristë dhe për të gjithë eventet në këtë vend mbi proceset zgjedhore se cfarë rëndësie merr dhe cfarë garancie kërkon ky lloj dokumentacioni në momente të caktuara. Kështu që përmbajtja që ju u referuat nuk të bënte të ngrije dorën kundra ta hidhje poshtë.

**Znj.I.Nano:** Zonja Vukaj ju lutem mos paragjykoni mënyrën sesi unë votoj, janë dhe dy kolegë të tjerë që kanë votuar kundër. Unë votoj sipas ligjit dhe sipas bindjes sime.

**Znj.H.Vukaj:** Ju mund të votoni si të doni.

**Znj.I.Nano:** Dhe ju mund propozoni cfarë të doni. Secili ka votën e vet fjalën e vet, ndaj propozimit tuaj u votua kundër me 3 vota.



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisioneri Rregulator*

*Dt.22.01.2021, ora 17:30*

**Znj.H.Vukaj:** Garancitë unë do t'i mbroj deri në fund maksimalisht duke propozuar shtesa madje përforcime për to. Në qoftë se ju nuk i doni këto garanci është çështja juaj.

**Znj.I.Nano:** Ju lutem të mos keqintepretojmë qëndrimin e njëri-tjetrit. Nuk është cështje e mungesës vullnetit dëshire për të pasur garanci dhe transparencë sepse pikërisht jemi live dhe të dëgjojë kushdo qëndrimin e gjithkujt sa është apo jo në përputhje me ligjin.

**Znj.H.Vukaj:** Absolutisht është në përputhje me ligjin.

**Znj.I.Nano:** Atëherë unë ju propozoj të bëjmë 10 minuta pushim për të kaluar në nenet e fundit pikat e fundit e projektvendimit për t'i votuar në mënyrë që ësecili duke nisur nga unë ju zonja Vukaj, zoti Çakaj, zoti Çaka, zoti Çela të mund të reflektojmë në mënyrën e zhvillimit të mbledhjes nëse vlerësoni propozimin tim bëjmë 10 minuta pushim.

**Znj.H.Vukaj:** Bëjmë pushim po jo për të reflektuar për mënyrën sesi bëhen mbledhjet, sepse jemi që të gjithë të qartë dhe që të gjithë me integritetin e duhur për të përfaqësuar veten dhe vendin e anëtarit të Komisionit Rregulator.

**Znj.I.Nano:** Dhe për këtë arëyse nuk mund të etiketojmë njëritjetrin.

**Znj.H.Vukaj:** Absolutisht nuk e etiketuam njëri-tjetrin por i qëndruam asaj cfarë kemi në përbajtjen tonë prej juristi dhe për të garantuar sa më shumë ata që na ndjekin.

**Znj.I.Nano:** Po e myllim dhe e hapim pas 10 minutash mbledhjen.



*Procesverball i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator i Zgjedhjeve  
Dt.22.01.2021, ora 17:30*

**Rifllon mbledhja e Komisionit Rregulator**

**Ora 19:50**

**Znj.I.Nano:** Përshëndetje të nderuar kolege! Jemi rikthyer në mbledhjen e Komisionit Rregulator. Jemi të gjithë anëtar të Komisionit Rregulator dhe përfaqësues të administratës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Përpara se të mbyllnim para pak minutash mbledhjen për ta shtyrë... Zoti Çakaj?

**Z.M.Çakaj:** Po e nderuar!

**Znj.I.Nano:** Kam përshtypjen që ju ndërpresa në momentin që propozova shtyrjen e mbledhjes.

**Z.M.Çakaj:** Po, atëhere duke qënë se ne diskutuam pikën 4 dhe ajo u nda në dy fjali se s'mund të thuash paragrafe dhe fjalinë e parë e votuam realisht me ndryshimet e propozuara nga kolegia Vukaj dhe u propozua me 5 vota pro. Nuk gjetëm dakordësi tek fjalia e dytë. Ajo çfarë unë u mundova të propozojë në debat e sipër, por për shkak edhe të debatit nuk u dëgjuar kam përshtypjen , ishte duke qënë se propozimi që edhe unë e mbështeta për referencën ligjore nen 178, pika 6, nuk u dakordësua në mes të anëtarëve të Komisionit Rregulator. Atëhere unë do të doja të shtroja për diskutim, shqyrtim dhe më pas dhe votim një propozim tjetër. Pra, e rëndësishme në gjykimin tim personal është që materiali filmik përvçe se të parashikojmë të gjitha karakteristikat teknike dhe gjithë mënyrën se si do instalohet dhe do funksionojë, momenti shumë i rëndësishëm është dhe ruajtja e këtij materiali filmik. Nga ana tjetër ne propozuam ruajtjen e materialit filmik në dy momente. Pra afatet kohore, së pari ruajtja në periudhën kohore në KQZ që shërben për verifikimin pas zgjedhor dhe më pas se si do ta trajtojmë.



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator i Zgjedhjeve  
Dt.22.01.2021, ora 17:30*

Konkretisht nuk po zgjatem më shumë, une propozoj që fjalia e dytë e pikës 4 të projektaktit të riformulohet. Pra...

**Znj.I.Nano:** Propozoni të shtohet një fjali e dytë se fjalinë e parë e kemi miratuar.

**Z.M.Çakaj:** Po, propozohet që pas fjalisë së parë të shtohet fjalia e dytë me këtë përmbajtje: “Pas kalimit të këtij afatit (që nënkupton në fjalinë e parë afatin e ruajtjes) regjistrimi filmik (për koherencë edhe të pikës dy), do të ruhet në arkivin e shtetit në përputhje me parashikimet e ligjit për arkivën”.

Atëhere e rithem përsëri: “Pas kalimit të këtij afati ( që i referohet fjalisë më sipër të pikës 4) regjistrimi filmik dërgohet dhe ruhet në Arkivën Qendrore të Shtetit në përputhje me parashikimet e Ligjit “Për arkivën”. Ose ndryshe, pas kalimit të këtij afati, regjistrimi filmik ruhet ne përputhje...

**Znj.I.Nano:** Me Ligjin “Për arkivat”...

**Z.M.Çakaj:** Po, me Ligjin “Për arkivat”. Ligji “Për arkivat” parashikon dhe arkivën e brendshme të institucionit si dhe pas kalimit të një afati kohor të caktuar në varësi dhe të materialit, momentin procedural se kur dërgohet në Arkivin Qendror. Kështu që me Ligjin “Për arkivat” besoj se jemi në rregull me bazen ligjore.

**Znj.I.Nano:** Atëhere, propozimi juaj është, fjalia e dytë e pikës 4 është “Pas kalimit të afatit, sipas kësaj pike, materiali i regjistruar ruhet në përputhje me Ligjin “Për arlkivat”. Sipas kësaj pike meqënëse jemi tek fjalia, fjalia e parë e pikës 4 . “Pas kalimit të afatit të parashikuar në këtë pikë ose sipas kësaj pike...



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator i Zgjedhjeve  
Dt.22.01.2021, ora 17:30*

**Z.M.Çakaj:** Dakord, por që të jemi konkret, “Pas kalimit të afatit të parashikuar në fjalinë e parë të kësaj pike...

**Znj.I.Nano:** Dakord, e saktësojme, “në fjalinë e parë të kësaj pike, materiali filmik...

**Z.M.Çakaj:** “Materiali filmik do të ruhet në përputhje me Ligjin “Për arkivat”.

**Znj.I.Nano:** Dakord, ky është propozimi i Zotit Çakaj. Kolegë keni ndonjë propozim tjetër, apo ndonjë koment, apo të kalojmë në votim ju lutem?

**Znj.H.Vukaj:** E gjej me vend personalisht edhe këtë propozim përgjithësues, por nuk është se pashë që nuk shkonte dispozita në të cilën unë u referova. Megjithatë le ta vazhdojmë procesin edhe me votimin e zotit Çakaj, të cilin sa po e dëgjuam. Faleminderit!

**Znj.I.Nano:** Faleminderit Zonja Vukaj! Zoti Çaka, Zoti Çela keni ndonjë koment praprak apo të kalojmë në votim?

**Z.D. Çaka:** Jo.

**Z.A.Çela:** Jo, une bashkohem me propozimin e zotit Çakaj.

**Znj.I.Nano:** Dakord, votojmë propozimin e zotit Çakaj që konsiston në shtesën, në pikën 4 të fjalisë së dytë “Pas kalimit të afatit sipas fjalisë së parë të kësaj pike materiali filmik ruhet në përputhje me Ligjin “Për arkivat”. Jam korrekte zoti Çakaj?



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Rregulator i Zgjedhjeve  
Dt.22.01.2021, ora 17:30*

**Z.M.Çakaj:** Po, korrekte.

**Znj.I.Nano:** Të nderuar kolegë ju ftoj ta votojmë propozimin e zotit Çakaj për shtesën në këtë pikë.

**Kush është pro propozimit?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Atëhere me 5 vota pro miratuam një shtesë në pikën 4. Për hir të rregullores do tu lutesha që pikën 4 ta votojmë në tërsi. Në fjalinë e parë kemi votuar një propozim të zonjës Vukaj dhe fjalia e dytë është shtesë e propozuar nga zoti Çakaj dhe e votuar nga të gjithë.

**Votojmë në tërsi pikën 4 ju lutem!**

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Atëhëre me 5 vota pro, miratohet pika 4 e projektvendimit!

Duke qënë që pika 4 u miratua, pika 5 dhe 6 janë dy pika që në përgjithësi nuk hasin në diskutime. Pika 5 lidhet me hyrjen në fuqi menjëherë dhe publikimin në faqen zyrtare të KQZ-së dhe e votojme fillimi i pikën 5?

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka

“Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.”

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka

*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator i Zgjedhjeve  
Dt.22.01.2021, ora 17:30*

Dhe pika e fundit e këtij projektvendimi, “Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës se Apelit Tiranë brenda 5 ditëve nga shpallja e tij”.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Atëhere me 5 vota pro miratohet pika 6!

Të nderuar kolegë është momenti të votojmë në tërësi aktin, i cili pësoi disa ndryshime dhe shtesa, kështu që do t'u ftoja të votojmë aktin në tërësi.

**Kush është dakord me projektvendimin, me shtesat dhe ndryshimet e miratuara tashmë?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Sapo kemi miratuar projektvendimin “Për rregullat proceduriale, për përdorimin e kamerave rregjistruese, e monitorëve (ekraneve) në vendet e numërimit të votave dhe transmetimi në kohë reale nga vendi i numërimit të votave në ambjentet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”, për zgjedhjet e Kuvendit të datës 25 prill 2021.

Përpara se ta mbyll mbledhjen, do të doja të kujtoja për administratën, me së pari atë që zonja Vukaj vuri në dukje në fillim të mbledhjes. Firmosjen e lidhjeve me detaje teknike të cilat u propozuan nga ju dhe u miratuan nga ne. Gjithashtu zoti Kaziaj në fillim të mbledhjes shtroi shqetësimin që një nga lidhjet nuk i ishte dërguar, kështu që në momentin e dërgimit të materialeve të mbledhjes të përfaqësuesve të partive politike do tu lutesha që të mos harronin ndonjë nga materialet siç janë dhe aktet që kanë anekse apo dhe lidhje bashkëlidhur.

Të nderuar kolegë me miratimin e këtij akti e deklaroj mbledhjen të mbyllur, natën e mire!

*Vendimi nr.1*

